

# **BANKA CREDIT AGRICOLE ALBANIA SH.A.**

(ish Banka Emporiki Albania SH.A)

Pasqyrat Financiare për vitin  
**e mbyllur më 31 Dhjetor 2013**

(së bashku me opinionin e audituesit të pavarur)

# tja

## Përmbajtja

# Përmbajtja

<b>RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR</b>	<b>36</b>
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013	37
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2013	38
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013	39
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013	40
1. Informacion i përgjithshëm	41
2. Politikat kontabël	41
3. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve	50
4. Menaxhimi i rrezikut financiar	51
5. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me Bankën Qëndrore	71
6. Hua dhe paradhënie ndaj bankave	71
7. Letra me vlerë të vlefshme për shitje	72
8. Hua dhe paradhënie për klientët	73
9. Aktive afatgjata materiale	75
10. Aktivet afatgjata jomateriale	76
11. Aktive të tjera dhe tatim fitim i parapaguar	76
12. Detyrime ndaj bankave	77
13. Detyrime ndaj klientëve	78
14. Borxhi i varur	79
15. Detyrime të tjera	80
16. Aktive tatimore të shtyra	81
17. Kapitali aksionar	81
18. Rezerva ligjore	82
19. Të ardhura nga interesat	82
20. Shpenzime për interesa	82
21. Të ardhura neto nga komisionet	83
22. Fitimi neto nga transaksionet në monedhë të huaj	83
23. Të ardhura/ (shpenzime) të tjera	84
24. Shpenzime të tjera operative	84
25. Rreziku operacional dhe kosto të tjera të riskut	85
26. Tatim fitimi	85
27. Mjetet monetare dhe ekuivalentet në fund të vitit	86
28. Analizë maturiteti për aktivet dhe detyrimet	86
29. Angazhime dhe detyrimet e kushtëzuara	87
30. Transaksionet e palëve të lidhura	88
31. Prezantimi i instrumentave financiar sipas kategorisë së matjes	90
32. Ngjarjet pas datës së raportimit	90

**RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR  
PËR AKSIONARËT E CREDIT AGRICOLE BANK ALBANIA SH.A.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Credit Agricole Bank Albania sh.a. ("Banka") të cilat përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2013, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit dhe pasqyrën e fluksit të parasë për ushtrimin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

**Pergjegjësia e Drejtimit per pasqyrat financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrole të brendshme të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimeve.

**Përgjegjësia e Audituesve**

Përgjegjësia jonë është që, duke u bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne t'u përmbahemi kërkesave etike të përshtatshme dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë që mbështet tepricat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit të audituesit, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, prej mashtrimit apo gabimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi shqyrton kontrollin e brendshëm i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinioni për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit jep një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për opinionin tonë.

**Opinion**

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë për gjendjen financiare të Credit Agricole Bank Albania sh.a. më 31 Dhjetor 2013, dhe për ecurinë financiare të saj, dhe fluksin e parasë për ushtrimin e mbyllur, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ernst & Young Certified Auditors Shpk,  
Skopje-Tirana Branch

Mario Vangjeli  
Partneri i auditimit

7 Maj 2014  
Tirana, Shqipëri

**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013**

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013 LEK '000	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012 LEK '000
Të ardhura nga interesat	19	1,694,371	2,155,128
Shpenzime për interesa	20	(721,713)	(858,248)
<b>Të ardhura neto nga interesat</b>		<b>972,658</b>	<b>1,296,880</b>
Të ardhura nga tarifa dhe komisione		186,462	159,369
Shpenzime për tarifa dhe komisione		(59,621)	(51,373)
<b>Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet</b>	21	<b>126,841</b>	<b>107,996</b>
Fitimi neto nga transaksionet në monedhë të huaj	22	52,567	44,846
Të ardhura/shpenzime të tjera	23	8,790	37
<b>Të ardhura të tjera bankare</b>		<b>61,357</b>	<b>44,883</b>
<b>Shpenzime të tjera operative</b>	<b>24</b>	<b>(1,062,087)</b>	<b>(1,159,550)</b>
Humbje nga zhvlerësimi i kredive, paradhënies dhe letër garancive	8, 15	(325,183)	(972,806)
Rreziku operacional dhe kosto të tjera risku	25	(199,005)	(10,162)
<b>Totali i Kostos së Riskut</b>		<b>(524,188)</b>	<b>(982,968)</b>
<b>Humbja e vitit, përpara tatim fitimit</b>		<b>(425,419)</b>	<b>(692,759)</b>
Shpenzimi i tatim fitimit	26	(5,369)	(17)
<b>Humbja neto e vitit</b>		<b>(430,788)</b>	<b>(692,776)</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>			
<i>Zërat që do të riklasifikohen në fitim ose humbje në periudhat e mëpasshme:</i>			
Fitimi/(humbja) neto nga rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje		2,033	(993)
Efeki i tatim fitimit		-	99
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse që do të riklasifikohen në fitim ose humbje në periudhat e mëpasshme</b>		<b>2,033</b>	<b>(894)</b>
<b>Totali i humbjes gjithëpërfshirëse të vitit pas tatim fitimit</b>		<b>(428,755)</b>	<b>(693,670)</b>

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5-50 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Bordi i Drejtorëve më 11 Prill 2014 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Luc Beiso  
Drejtor Ekzekutiv

Armand Muharremi  
Drejtor i Departamentit të Financës

Pasqyra e pozicionit financiar  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

	Shënime	31 Dhjetor 2013 ALL '000	31 Dhjetor 2012 ALL '000
<b>Aktivët</b>			
Mjetet monetare dhe gjendja me Bankën Qendrore	5	2,929,021	3,286,273
Hua dhe paradhënie bankave	6	5,725,950	5,802,129
Aktive financiare të vlefshme për shitje	7	983,609	851,926
Hua dhe paradhënie klientëve	8	17,315,310	19,415,172
Aktivët afatgjata materiale	9	581,948	589,755
Aktivët afatgjata jomateriale	10	210,633	235,546
Aktive të tjera	11	2,753,858	2,264,595
Aktive tatimore të shtyra	16	10,223	15,592
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>30,510,552</b>	<b>32,460,988</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj bankave	12	5,303,943	8,780,743
Detyrime ndaj klientëve	13	19,025,666	17,042,388
Borxhi i varur	14	1,420,350	1,414,269
Detyrime të tjera	15	348,582	382,822
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>26,098,541</b>	<b>27,620,222</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	17	6,807,186	6,807,186
Rezerva ligjore	18	57,162	57,162
Rezerva nga rivlerësimi		3,085	1,052
Humbja e akumuluar		(2,455,422)	(2,024,634)
<b>Totali kapitalit</b>		<b>4,412,011</b>	<b>4,840,766</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>30,510,552</b>	<b>32,460,988</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 5-50 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

	Kapitali aksionar ALL '000	Rezerva ligjore ALL '000	Rezerva nga rivlerësimi ALL '000	Humbja e akumuluar e akumuluar ALL '000	Totali ALL '000
<b>Gjëndja më 1 Janar 2012</b>	<b>5,348,726</b>	<b>57,162</b>	<b>1,946</b>	<b>(1,331,858)</b>	<b>4,075,976</b>
Rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje	-	-	(894)	-	(894)
Humbja neto e vitit	-	-	-	(692,776)	(692,776)
<b>Totali i humbjes gjithëpërfshirëse e vitit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(894)</b>	<b>(692,776)</b>	<b>(693,670)</b>
Rritja e kapitalit aksionar	1,465,375	-	-	-	1,465,375
Rregullimi i diferencave nga kursi i këmbimit	(6,915)	-	-	-	(6,915)
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>6,807,186</b>	<b>57,162</b>	<b>1,052</b>	<b>(2,024,634)</b>	<b>4,840,766</b>
Rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje	-	-	2,033	-	2,033
Humbja neto e vitit	-	-	-	(430,788)	(430,788)
<b>Totali i humbjes gjithëpërfshirëse e vitit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>2,033</b>	<b>(430,788)</b>	<b>(428,755)</b>
Rritja e kapitalit aksionar	-	-	-	-	-
Rregullimi i diferencave nga kursi i këmbimit	-	-	-	-	-
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>6,807,186</b>	<b>57,162</b>	<b>3,085</b>	<b>(2,455,422)</b>	<b>4,412,011</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 50 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
		ALL '000	ALL '000
<b>Fluksi monetar nga aktivitetet operative</b>			
Humbja neto para tatim fitimit		(425,419)	(692,759)
<b>Rregullimet për rakordimin e fitimit neto me fluksin e parasë nga aktiviteti operativ:</b>			
Amortizimi dhe zhvlerësimi	9,10	142,616	171,424
(Fitimi)/humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata	9	(11,136)	4,446
Humbje nga zhvlerësimi i kredive dhe paradhënieve		321,546	1,094,458
Rimarrja e provigjoneve per kreditë e fshira		(254,762)	(272,338)
Provigjone për detyrimet e kushtëzuara		3,637	3,087
Provigjone operative dhe të tjera		190,968	10,106
Humja/(fitimi) i perealizuar nga rivlerësimi i transaksioneve në monedhë të huaj		1,047	(1,984)
Likuidimi i tatim fitimit të parapaguar		-	51,451
<b>Fluksi monetar nga aktivitetet operative përpara ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative</b>			
<b>(31,503)</b>			
<b>367,891</b>			
<b>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative:</b>			
Rritje e rezervës së detyrueshme me Bankën e Shqipërisë	5	(100,270)	(388,321)
Rënie në hua dhe paradhënie klientëve	8	2,021,887	556,072
Rritje në aktive të tjera	11	(615,444)	(1,179,482)
Rënie në detyrime ndaj bankave	12	(3,476,800)	(4,681,605)
Rritje në detyrime ndaj klientëve	13	1,983,279	4,153,868
Rënie në detyrime të tjera	15	(98,297)	(174,428)
<b>Fluksi monetar neto përdorur në aktivitetet operative</b>			
<b>(317,148)</b>			
<b>(1,346,005)</b>			
<b>Fluksi monetar nga aktivitetet investuese</b>			
Blerje e aktiveve afatgjata jo materiale	10	(11,727)	(53,852)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	9	(98,794)	(129,865)
Fitimi nga shitja e aktiveve afatgjata material	9	11,761	-
Purchases of AFS securities		(1,747,794)	(880,000)
Fitimi nga letrat me vlerë të maturuara		1,630,000	938,745
<b>Fluksi monetar përdorur në aktivitetet investuese</b>			
<b>(216,554)</b>			
<b>(124,972)</b>			
<b>Fluksi monetar nga aktivitetet financuese</b>			
Rritje e kapitalit aksionar		-	1,465,375
Borxhi i varur	14	-	(125,631)
<b>Fluksi monetar neto i gjeneruar nga aktivitetet financuese</b>			
<b>-</b>			
<b>1,339,744</b>			
<b>Rënia neto në mjete monetare dhe ekuivalente</b>			
<b>(533,702)</b>			
<b>(131,233)</b>			
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalente më 1 Janar</b>			
<b>7,444,217</b>			
<b>7,575,450</b>			
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalente më 31 Dhjetor</b>			
<b>6,910,515</b>			
<b>7,444,217</b>			

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 50 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# 1. Informacion i përgjithshëm

Credit Agricole Bank Albania Sh.A. (Credit Agricole Albania apo Banka), është një filial në pronësi të plotë të IUB Holding, një shoqëri anonime Franceze “par actions simplifiées”, 100% filial i drejtpërdrejtë i Credit Agricole S.A. Credit Agricole SA është një Shoqëri Anonime Franceze e regjistruar dhe një nga grupet më të mëdha financiare në Europë, themeluar që nga viti 1894.

Credit Agricole Albania u krijua fillimisht si një degë e Bankes Tregtare të Greqisë (aktualisht Banka Emporiki e Greqisë S.A.) në Tetor 1998. Në Tetor 1999, Banka, duke u quajtur fillimisht Intercommercial Bank - Albania Sh.A., ishte e autorizuar për të vepruar në të gjitha fushat e aktivitetit bankar. Gjatë vitit 2001 Banka ndryshoi emrin e saj në Bankën Tregtare të Greqisë (Albania) Sh.a. Më 1 Mars 2004, emri i Bankës u ndryshua në Emporiki Bank Albania Sh.A.

Në Qershor të vitit 2012 Banka Emporiki e Greqisë S.A ia shiti IUB Holding 100% të pjesëmarrjes së saj në filialin e zotëruar 100% të Emporiki Bank Albania sh.a. Miratimet rregullatore duke përfshirë edhe ndryshimin e emrit janë finalizuar në datën efektive juridike 3 Shtator 2012.

Banka operon në përputhje me Ligjin Nr. 9662 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” të datës 18 Dhjetor 2006. Banka është e licensuar për të kryer aktivitetet e kreditimit dhe depozitimit, shërbimet e pagesave në Shqipëri dhe jashtë saj si dhe aktivitetet e tjera bankare në përputhje me ligjet Shqiptare.

Në 31 Dhjetor 2013, kapitali i regjistruar aksionar ishte LEK 6,807,186 (2012: 6,807,186), të ndarë në 60,420 aksione (2012: 60,420) me një vlerë nominale prej LEK 112,664.45.

Zyra Qendrore e Credit Agricole Bank Albania është e vendosur në Tiranë në Rrugën e Kavajës, Godina 27 kati 8 hyrja 1. Banka operon vetëm në Shqipëri me një rrjet prej 20 degësh më 31 Dhjetor 2013 (2012: 22 degë). Shtatë degë janë të vendosura në Tiranë dhe degët e tjera janë të vendosura në Durrës, Kavajë, Lushnje, Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë, Korçë, Lezhë dhe Shkodër, e ndjekur nga 2 agjenci në Portin e Durrësit dhe në Kakavijë. Banka ka 259 të punësuar më 31 dhjetor 2013 (2012: 254), nga të cilët 149 (2012: 152) janë të punësuar në Zyrën Qendrore.

# 2. Politikat kontabël

## 2.1 BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të aktiveve afatgjata të vlefshme për shitje dhe investimeve të vlefshme për shitje të cilat janë matur me vlerë të drejtë.

Pasqyrat financiare paraqiten në LEK, e cila është monedha funksionale e Bankës, dhe të gjitha vlerat janë të rumbullakosur në mijëshen më të afërt (ALL '000), përveç rasteve kur shprehet ndryshe.

### (a) Deklarata e Përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

### (b) Paraqitja e pasqyrave financiare

Banka paraqet pasqyrën e pozicionit financiar kryesisht sipas rendit të likuiditetit. Një analizë lidhur me arkëtimin ose shlyerjen brenda 12 muajve pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar (afatshkurtër), dhe më vonë se 12 muaj pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar (afatgjatë) paraqitet në shënimin 28.

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka të drejtë ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Te ardhurat dhe shpenzimet nuk kompensohen në Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse vetëm nëse kërkohet ose lejohet nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet, dhe siç shpjegohet në mënyrë specifike në politikat kontabël të Bankës.



## 2.2 ADOPTIMI I INTERPRETIMEVE DHE STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA

Banka ka adoptuar të gjithë standardet dhe interpretimet e reja dhe të rishikuarat të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe Komiteti i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe Interpretimeve (KIRFN) të cilat janë të aplikueshme për aktivitetet e saj.

Standardet e mëposhtme, amendimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese janë të detyrueshme për periudhat kontabël të Bankës që fillojnë më ose pas 1 Janar 2013.

(a) Ndryshimet në politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese

Politikat kontabël të adoptuara janë konsistente me ato të vitit financiar të mëparshëm. Amendimet që rezultojnë nga përmirësimet e SNRF-ve nuk kanë ndonjë impakt në politikat kontabël, pozicionin financiar ose performancën e Bankës.

Deklaratat e reja (standardet e reja, amendimet/rishikimet e standardeve ose interpretimeve) të publikuara brenda vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2013.

### **(i) Standardet e publikuara dhe efektive**

Interpretimet dhe amendimet e reja të mëposhtme të standardeve bëhen të detyrueshme për here të parë për periudhën financiare që fillon më 1 Janar 2013:

SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare (e amenduar) – Paraqitja e zërave të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse Amendimet e SNK 1 ndryshojnë mënyrën e grupimit të zërave që paraqiten tek të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Zërat që mund të riklasifikohen (apo “riciklohen”) në fitim apo humbje në një të ardhme (për shembull, fitimi neto nga mbrojtja e investimeve neto, diferencat nga kurset e kembimit, lëvizjet neto nga flukset monetare mbrojtëse dhe humbja ose fitimi neto nga aktivet e vlefshme per shitje) do të paraqiten të ndara nga ato zëra të cilat nuk do të riklasifikohen kurrë (per shembull, humbjet dhe fitimet aktuariale nga skemat me përfitime të përcaktuara dhe rivlerësimi i tokës dhe ndërtesave). Amendimi ndikon vetem prezantimin dhe nuk ka ndikim në pozicionin apo performancën financiare të Bankës. Banka paraqet të ndara në Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse zërat që do të riklasifikohen në fitim apo humbje në periudhat e mëpasshme. Nuk ka asnjë zë që nuk mund të riklasifikohet asnjëherë në fitim apo humbje.

SNK 19 Përfitimet e Punonjësve (e rishikuar)

SNK 19 trajton një numër të amendimeve për kontabilizimin e skemave me përfitime të përcaktuara, duke përfshirë fitimet dhe humbjet aktuariale, që janë njohur tashmë në Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, dhe që janë përkohësisht të përgjashtuara nga fitimi ose humbja; kthimi i pritshëm mbi aktivet e skemës që nuk janë më të njohura në fitim ose humbje, e në vend të kësaj, ka një kërkësë për të njohur interesa nga detyrimet/(aktivet) neto me përfitime të përcaktuara ne fitim ose humbje, e llogaritur duke përdorur normën e skontimit për të matur detyrimet e skemave me përfitime të përcaktuara dhe; kostot e shërbimit të shkuar tashmë njihen në fitim ose humbje para se rishikimet të ndodhin, ose shpenzimet e ristrukturimit ose të mbarimit të njihen. Rishikimet e tjera përfshijnë shënime të reja shpjeguese, të tilla si informacione shpjeguese sasiore. Në rastin e Bankës, adoptimi i standardit të rishikuar nuk ka pasur asnjë ndikim në pasqyrat financiare.

SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese (e amenduar) - Shuarja e Aktiveve dhe Detyrimeve Financiare

Këto amendime i kërkojnë njësisë ekonomike të japin informacione shpjeguese për te drejten e kompensimit dhe marrëveshjet e lidhura (përshembull marrëveshjet me kolateral). Këto shënime shpjeguese do t'u ofrojnë përdoruesve informacion që është i dobishëm në vlerësimin e efektit të marrëveshjeve neto, mbi pozicionin financiar të njësisë ekonomike. Shënimet e reja shpjeguese duhet të zbatohen për të gjithë instrumentat financiarë që janë jashtë përkufizimit të SNK 32, Instrumentat Financiarë: Paraqitja. Dhënia e informacioneve shpjeguese duhet të zbatohet në njohjen e instrumentave financiarë që janë subjekt i marrëveshjeve kompensimi të brendshme ose marrëveshjeve të ngjashme, pavarësisht se janë jashtë përkufizimit të SNK 32. Adoptimi i amendimit të mësipërm nuk ka pasur ndikim ne pasqyrat financiare të Bankës.

SNRF 13 Matja me vlerën e drejtë

SNRF 13 krijon një burim të vetëm udhëzimesh sipas SNRF për të gjitha matjet e vlerës së drejtë. SNRF 13 nuk ndryshon kur një njësi ekonomike është e nevojshme të përdorë vlerën e drejtë, por jep udhëzime se si të masësh vlerën e drejtë sipas SNRF kur vlera e drejtë është e nevojshme të perdoret ose lejohet. Aplikimi i SNRF 13 nuk ka ndikuar materialisht në matjet me vlerën e drejtë të kryera nga Banka. SNRF 13 gjithashtu kërkon shënime shpjeguese të vecanta mbi vlerën e drejtë, disa prej të cilave zëvendësojnë shënimet shpjeguese aktuale të kërkuara nga standarde të tjera, duke përfshirë SNRF 7 Instrumentat financiarë: Dhënia e shënimeve shpjeguese. Banka ka shtuar shënimet shpjeguese të nevojshme të kërkuara nga standardi i amenduar.

SNRF 10 Pasqyrat financiare të konsoliduara, SNK 27 Pasqyrat financiare individuale

SNRF 10 zëvendëson pjesën e SNK 27 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale, që trajton kontabilitetin për pasqyrat financiare të konsoliduara. Ajo gjithashtu përfshin çështjet e ngritura në KIS-12 Konsolidimi - Subjektet për Qëllime të Veçanta. SNRF 10 përcakton një model të vetëm të kontrollit që vlen për të gjitha subjektet, duke përfshirë subjektet për qëllime të veçanta. Ndryshimet e paraqitura nga SNRF 10 do t'i kërkojnë drejtimit të ushtrijë gjykimin e rëndësishëm për të përcaktuar se cilat subjekte janë të kontrolluara, dhe për këtë arsye, është e nevojshme të konsolidohen nga një prind, në krahasim me kërkesat që ishin në SNK 27. SNRF 10 nuk ndryshon procedurat e konsolidimit (psh, si të konsolidohet një shoqëri). Përkundrazi, SNRF 10 ndryshon nëse një njësi ekonomike është e konsoliduar duke rishikuar përkufizimin e kontrollit. Aplikimi i këtij standardi nuk ka pasur ndikim ne pasqyrat financiare te Bankës.

SNRF 11 Marrëveshjet e përbashkëta

SNRF 11 zëvendëson SNK 31 Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta dhe KIS-13 Njësitë Ekonomike të kontrolluara- të përbashkëta – Kontributet jo-monetare nga Sipërmarrjet. SNRF 11 ndryshon mundësinë të kontabilizimit për njësitë ekonomike të kontrolluara të përbashkëta dukë përdorur konsolidimin proporcional. Në vend te kësaj, njësitë ekonomike të kontrolluara të përbashkëta që përmbushin përkufizimin e sipërmarrjeve të përbashkëta duhet të kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit. Aplikimi i këtij standardi nuk ka pasur ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

SNRF 12 Dhënia e informacioneve shpjeguese

në lidhje me interesat në njësitë e tjera ekonomike SNRF 12 përfshin të gjitha informacionet shpjeguese që ishin më parë në SNK 27 në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduara, si dhe të gjitha informacionet shpjeguese që ishin të përfshira më parë në SNK 31 dhe SNK 28. Këto informacione shpjeguese kanë të bëjnë me interesat e një njësie ekonomike në filiale, marrëveshjet e përbashkëta, bashkëpunëtorët dhe subjektet e strukturuara. Disa shpejgimetë reja janë gjithashtu të detyrueshme. Adoptimi i këtij standardi nuk do ka pasur ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

Udhëzime në lidhje me tranzicionin

(amendimet në SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12)

BSNK publikoi ndryshimet në SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta dhe SNRF 12 Informacioni Shpjegues për Interesat ne Njësitë Ekonomike të Tjera. Amendimet ndryshojnë udhëzimet mbi tranzicionin për të siguruar lehtësim të mëtejshëm nga zbatimi i plotë retrospektiv. Data e aplikimit fillestar në SNRF 10 është përcaktuar si ‘fillimi i peri-

udhës raportuese vjetore në të cilën SNRF 10 është aplikuar për herë të parë. Vlerësimi nëse ekziston kontrolli apo jo, është bërë në ‘datën e aplikimit fillestar’ sesa në fillim të periudhës krahasuese. Nëse vlerësimi i kontrollit është i ndryshëm mes SNRF 10 dhe SNK 27/KIS-12, rregullime retrospektive duhet të përcaktohen. Megjithatë, nëse vlerësimi i kontrollit është i njëjtë, nuk është i nevojshëm zbatimi i aplikimit retrospektiv. Nëse më shumë se një periudhë krahasuese është paraqitur, lehtësim shtesë jepet, duke kërkuar riparqitjen e vetëm një periudhe. Për të njëjtat arsye BSNK ka amenduar edhe SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta dhe SNRF 12 Informacioni Shpjegues për Interesat në Subjektet e Tjera për të siguruar lehtësim të tranzicionit. Adoptimi i këtij standardi nuk ka pasur ndikim në pasqyrat financiare të bankës.

### **(ii) Standarde të publikuara që nuk kanë hyrë ende në fuqi**

Standardet e publikuara por që nuk kanë hyrë në fuqi në datën e publikimit të pasqyrave financiare të bankës, janë të listuara më poshtë. Ky është një listim i standardeve dhe interpretimeve të publikuara, të cilat banka në mënyrë të arsyeshme pret të jenë të aplikueshme në një datë të ardhshme. Banka pret të adoptojë këto standarde kur ato të hyjnë në fuqi.

SNK 32 Intrumentet Financiare: Paraqitja (e amenduar) - Shuarja e Aktiveve dhe Detyrimeve Financiare Amendimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2014. Ky ndryshim sqaron kuptimin e “aktualisht ka një të drejtë ligjore që të kryejë një kompensim”. Amendimi gjithashtu sqaron aplikimin e kritereve kompensuese të SNK 32 në sistemet e shlyerjes (si sistemet qëndrore të shlyerjes të shtëpive) të cilat zbatohen mekanizma të zgjidhjes bruto që nuk janë të njëkohshëm. Drejtimi i njësisë ka vlerësuar se adoptimi i amendimeve të mësipërme nuk do të ketë impakt në pasqyrat financiare të Bankës.

SNRF 9 Instrumentat Financiarë: Klasifikimi dhe matja dhe amendime të mëvonshme të SNRF 9 dhe SNRF 7 – Data efektive e detyrueshme e hyrjes në fuqi dhe udhëzimet per tranzicionin; Kontabiliteti mbrojtës dhe amendimet në SNRF 9, SNRF 7 dhe SNK 39

SNRF 9, pasqyron fazën e parë të punës së BSNK-se për zëvendësimin e SNK 39 dhe zbatohet për klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare, siç përcaktohet në SNK 39. Adoptimi i fazës së parë së SNRF 9 do të ketë një ndikim në klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare, por nuk do të ketë ndikim në klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare. Në fazat e mëvonshme, BSNK do të trajtojë kontabilitetin mbrojtës dhe zhvlerësimin e aktiveve financiare. Standardi fillimisht ishte efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose

pas datës 1 Janar 2013, por amendimet e SNRF 9 Data Efektive e Detyrueshme e Hyrjes në Fuqi dhe Udhëzime të Tranzicionit, të publikuara në Dhjetor 2011, e zhvendosën datën efektive të detyrueshme të hyrjes në fuqi në 1 Janar 2015. Rishikimet e mëvonshme të publikuara në Nëntor 2013 iniciojnë kërkesat e mëtejshme kontabël për instrumentat financiarë. Banka do të vlerësojë efektin në lidhje me fazat e tjera, kur të publikohet standardi final duke përfshirë të gjitha fazat.

Njësitë e Investimit (Amendimet në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27)  
Amendimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2014. Amendamenti zbatohet për një klasë të veçantë të biznesit që kualifikohen si njësi të investimeve. Një njësi investimi duhet të vlerësojë gjithashtu performancën e investimeve të tij mbi bazën e vlerës së drejtë. Njësi të tilla mund të përfshijnë organizatat e kapitalit privat, organizatat e kapitalit sipërmarrës, fondet e pensionit, fondet qeveritare të pasurisë dhe fonde të tjera investimi. Sipas SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, subjektet raportuese duhet të konsolidojnë të gjitha njesitë e investimit që ata kontrollojnë (p.sh.: të gjitha filialet). Amendimi i njësive të investimit, ofron një përjashtim për kushtin e konsolidimit në SNFR10 dhe kërkon që subjektet e investimit të vlerësojnë filiale të caktuara në bazë të vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, sesa t'i konsolidojnë ato. Gjithashtu, amendimi përcakton kërkesat për informacione shpjeguese për njesite e investimit. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij amendimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

SNK 36 Zhvlerësimi i aktiveve (amenduar) – Dhënia e shënimeve shpjeguese për shumat e rikuperueshme të aktiveve jo-financiare  
Amendimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2014. Këto ndryshime largojnë pasojat e padëshirueshme të SNRF 13 mbi dhënie të informacioneve shpjeguese të kërkuara sipas SNK 36. Përveç kësaj, këto amendime kërkojnë dhënie të informacioneve shpjeguese mbi shumat e rikuperueshme të aktiveve ose njësive gjeneruese të parasë, për të cilat humbjet nga rënia në vlerë janë njohur ose janë anuluar gjatë periudhës. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij amendimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

SNK 39 Instrumentat financiarë (amenduar): Njohja dhe matja – Zevendesimi (“novation”) i derivativeve dhe vazhdimi i kontabilitetit mbrojtës  
Amendamenti është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2014. Bazuar në amendimin nuk do të jetë e nevojshme për të ndërprerë kontabilitetin mbrojtës nese nje derivativ mbrojtës është zëvendësuar, me kusht që të plotësohen disa kriterë. BSNK kreu një rishikim të kufizuar mbi SNK 39 për të lejuar vazhdimin e kontabilitetit

mbrojtës në të cilin kunderpartia e instrumentit mbrojtës ndryshon me qëllim për të arritur qartësinë për atë instrument. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij amendimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

SNK 19 Plani i përcaktuar i përfitimeve (amenduar): Përfitimet e Punonjësve  
Amendimi është efektiv nga 1 Korrik 2014. Ky amendim zbatohet për kontributet nga punonjësit ose palët e treta në skemat e kontributeve të përcaktuara. Objekti i amendimit është të qartësojë kontabilizimin e kontributeve që janë të pavaruara nga numri i viteve të punonjësit që ka kryer shërbimin. Ky amendim nuk është miratuar ende nga BE-ja. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij amendimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

KIRFN Interpretimi 21: Taksat  
Interpretimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2014. Interpretimi sqaron se një shoqëri ekonomike njehe një detyrim për një takse, kur ndodh aktiviteti i cili gjeneron pagesën, sic identifikohet nga legjislacioni në fuqi. Ai gjithashtu sqaron se një detyrim taktimor është përlogaritur në mënyrë progresive vetëm në qoftë se aktiviteti i cili gjeneron pagesën ndodh për një periudhë kohore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për taksën e cila gjenerohet nga arritja e nje kufiri minimal, interpretimi sqaron se asnjë detyrim nuk duhet të njihet përpara se kufiri minimal i caktuar të arrihet. KIRFN 21 është i zbatueshëm për të gjitha taksat, përveç flukseve dalëse që janë subjekt i standardeve të tjera (p.sh SNK12) dhe gjopa e penalitete të tjera për shkelje të legjislacionit. Ky interpretim nuk është miratuar ende nga BE-ja. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij amendimi nuk do të ketë impakt në pasqyrat financiare të Bankës.

(iii) Përmirësime të SNRF-ve  
Më 12 Dhjetor 2013, BSNK ka publikuar dy cikle të Përmirësimeve Vjetore të SNRF-ve – Ciklet 2010-2012 dhe 2011-2013 – që përbajnë 11 ndryshime të nëntë standardeve. Ndryshimet e tjera janë efektive nga 1 Korrik 2014 qoftë në prospektive ose retrospective. Banka është në procesin e vlerësimit të ndikimit të përmirësimeve në pozicionin financiar dhe performancën e bankës. Një përmbledhje e këtyre amendimeve përshkruhen më poshtë:

Përmirësimet Vjetore të SNRF-ve Cikli 2010 – 2012  
SNRF 2 Pagesat e bazuara në aksione: Ky përmirësim ndryshon përkufizimet e “kushtit të perfitimit të aksioneve” dhe “kushtet e tregut” dhe shton përkufizimet për “kushtet e performancës”, dhe “kushtet e shërbimit” ( të cilat ishin më parë pjesë e përkufizimit të ‘kushtit të perfitimit të aksioneve’). Ky amendim është efektiv në prospektivë.  
SNRF 3 Kombinimet e biznesit: Ky përmirësim sqaron rrethanat e kushtëzuara në një blerje biznesi, që nuk është klasifikuar si kapital, e që më vonë mbahet me vlerën e

drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, edhe nëse nuk është objekt i SNRF 9 Instrumentat Financiarë. Ky amendim është efektivë në prospektivë për kombinimet e bizneseve.

SNRF 8 Segmentet e Shfrytëzimit: Ky përmirësim kërkon që njësia ekonomike të japë informacione shpjeguese mbi gjykimet e bëra nga drejtimi, në zbatimin e kriterëve të specifikuar në segmentet e shfrytëzimit dhe sqaron se njësia ekonomike duhet vetëm të kryejë rakordime të totalit të aktiveve të segmenteve raportuese me totalin e aktiveve të njësisë ekonomike, nëse aktivet e segmenteve raportohen rregullisht. Ky amendim është efektiv në retrospektivë.

SNRF 13 Matja me vlerën e drejtë: Ky përmirësim në Bazat e Përfundimit të SNRF 13 sqaron se publikimet e SNRF 13 dhe ndryshimet në SNRF 9 e SNK 39 nuk e heqin mundësinë për të matur llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra dhe llogaritë e pagueshme me asnjë normë interesi të shpallur nga shumat e faturave pa zbritje, nëse efekti i jo-zbritjes është jo material. Ky ndryshim hyn në fuqi menjëherë.

SNK 16 Aktivet afatgjata materiale: Amendimi sqaron se kur një njësi e aktiveve afatgjata materiale është rivlerësuar, vlera kontabël bruto është rregulluar në mënyrë të tillë që është në përputhje me rivlerësimin e vlerës së mbartur. Amendimi hyn në fuqi në retrospektivë.

SNK 24 Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura: Amendimi sqaron se një njësi ekonomike që ofron shërbime të personelit drejtues kryesor të njësia ekonomike raportuese ose mëma e njësisë raportuese është palë e lidhur e njësisë ekonomike. Amendamenti hyn në fuqi në retrospektive.

SNK 38 Aktivet afatgjata jomateriale: Amendimi sqaron se kur një njësi e aktiveve afatgjata jomateriale është rivlerësuar, vlera kontabël bruto është rregulluar në mënyrë të tillë që është në përputhje me rivlerësimin e vlerës së mbartur. Amendimi hyn në fuqi në retrospektivë.

Përmirësimet Vjetore të SNRF-ve Cikli 2011 – 2013  
IFRS 3 Business Combinations: This improvement clarifies that IFRS 3 excludes from its scope the accounting for the formation of a joint arrangement in the financial statements of the joint arrangement itself. The amendment is effective prospectively.

SNRF 13 Matja me vlerën e drejtë: Ky përmirësim sqaron se objekti i përjashtimit të portofolit të përcaktuar në paragrafin 52 të SNRF 13 përfshin të gjitha kontratat të trajtuara brenda objektit të SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja ose SNRF 9 Instrumentat Financiare, pavarësisht nëse ato plotësojnë përkufizimin e aktiveve financiare ose detyrimeve financiare sipas përcaktimit në SNK 32 Instrumentat Financiarë: Paraqitja. Amendimi është efektiv në prospektive.

SNK 40 Investimet në prona Ky përmirësim sqaron përcaktimin kur një transaksion specifik plotëson përkufizimet e

kombimit të biznesit sipas SNRF 13 Kombinimet e biznesit dhe investimet në pronësi sipas SNK 40 Investimet në Pronësi, kërkon zbatimin e vecantë të dyja standardeve të pavarur nga njëri tjetri. Ndryshimi është efektivë në prospektivë.

## 2.3 POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

**(a) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**  
Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtimi përdorimin e gjykimeve, vlerësimeve dhe supozimeve, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga ai i vlerësuar. Vlerësimet dhe supozimet e përdorura rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën ato kryhen dhe në periudhat e ardhshme që preken nga ky rishikim. Në veçanti, informacioni rreth fushave të rëndësishme të gjykimeve të pasigurta dhe ato kritike që përdoren gjatë aplikimit të politikave kontabël dhe që kanë ndikimin të rëndësishëm mbi vlerat e njohura në pasqyrat financiare është përshkruar në shënimin 3.

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

### (b) Transaksionet me monedhë të huaj

Transaksionet me monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale duke përdorur kurset e këmbimit në datat e transaksioneve. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga këto transaksione dhe nga konvertimi në fund të vitit i kurseve të këmbimit të aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse. Aktivitet dhe detyrimet jo monetare që janë matur me kosto historike në monedhë të huaj janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

### (c) Të ardhura nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat janë njohur në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton saktësisht pagesat dhe arkëtimet e ardhshme gjatë jetës së dobishme të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose, kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër) të vlera kontabël e aktivitetit ose detyrimit financiar. Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha tarifat dhe komisionet e paguara ose të marra, kostot e transaksioneve, dhe zbritjet ose primet që janë një pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksioneve janë kosto rritëse që janë drejtëpërdrejtë të lidhura me blerjen, shitjen apo nxjerrjen jashtë përdorimi të një aktivi apo detyrimi financiar.



Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse përfshijnë interesin mbi aktivet dhe detyrimet financiare me kosto të amortizuar dhe aktiveve financiare të vlefshme për shitje në bazën e normës së interesit efektiv.

#### **(d) Tarifat dhe komisionet**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifatat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv mbi një aktiv ose detyrim financiar janë përfshirë në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura të tjera nga tarifa dhe komisione, duke përfshirë tarifatat e shërbimit të llogarisë, tarifatat e vendosjes, janë njohur gjatë kryerjes së shërbimeve përkatëse.

Shpenzime të tjera për tarifa dhe komisione lidhen kryesisht me transaksione dhe tarifa të tjera për shërbime bankare, të cilat janë shpenzuar gjatë kryerjes së shërbimeve përkatëse.

#### **(e) Pagesat për qira operacionale**

Pagesat e kryera për qiratë operacionale janë njohur në pasqyrën e të ardhurave në një mënyrë konstante sipas afateve të qirasë. Zbritje të marra nga qiraja njihen si një pjesë përbërëse e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë kohëzgjatjes së saj.

#### **(f) Shpenzime të tjera operative**

Shpenzime të tjera operative njihen në momentin që ndodhin.

#### **(g) Përfitimet e punëmarrësit**

Obligimet për përfitimet afatshkurtra të punonjësve maten në një bazë të paskontueshme dhe njihen kur shërbimi përfitohet. Provizioni njihet për shumën e pritshme për tu paguar si një bonus afatshkurter në para në bazë të performancës.

Banka zbaton një plan të përcaktuar kontributesh për pensionet. Banka paguan kontribute në baza të detyrueshme sipas një plani sigurimesh pensionesh të administruar nga organet publike shtetërore. Banka nuk ka detyrime pagese të mëtejshme në momentin që kontributet janë paguar. Kontributet njihen si shpenzim për punonjësit në momentin që ato janë detyrim ligjor. Kontributet e parapaguara njihen si një aktiv deri në masën që kompensimi në para ose reduktimi në pagesa të ardhshme është i mundshëm.

#### **(h) Shpenzime për tatimim mbi fitimin**

Shpenzimet për tatimin mbi të ardhurat përfshijnë tatimet aktuale dhe të shtyra. Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat njihet në fitim ose humbje me përjashtim të rasteve të njohura direkt në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, rast kur njihen si të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e bilancit, dhe çdo rregullim në

tatimin e pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit, që jep ndryshime të përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës kontabël për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë llogaritet me normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur ato realizohen, bazuar në ligjet që kanë qënë në fuqi ose aprovuar (por që do të hyjnë në fuqi në vitet e mëpasshme) deri në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet vetëm në masën që është e mundur që fitimet e ardhshme të tatueshme do të realizohen përkundrejt të cilave do të shfrytëzohet aktivi. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më i mundur realizimi i fitimit të parashikuar.

#### **(i) Aktivet dhe detyrimet financiare**

##### ***i Njohja***

Banka fillimisht njeh huatë dhe paradhëniet, dhe depozi-tat, në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare fillimisht janë njohur në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

##### ***ii Çregjistrimi***

Banka e çregjistron një aktiv financiar kur aktivet janë shlyer ose kur të drejtat e bankës ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi kanë mbaruar, ose nëse banka i transferon të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare nga aktivi financiar nëpërmjet një transaksioni sipas të cilit në mënyrë thelbësore të gjithë rreziqet dhe përfitimet nga aktivi financiar janë transferuar. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që krijohet apo mbahet nga Banka njihet si aktiv ose detyrim i veçantë. Banka e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale që lidhen me të janë shfuqizuar, anuluar, ose i ka kaluar afati.

##### ***iii Matje e kostos së amortizimit***

Kosto e amortizimit e një aktivi ose detyrimi financiar është shuma në të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në vlerësimin fillestar, minus ripagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo ndryshimi ndërmjet shumës fillestare të njohur dhe shumës së maturuar, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

##### ***iv Matja e vlerës së drejtë***

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare bazohet në çmimet e caktuara të tregut ose në vlerësimet e çmimit nga agjentët e shitjes për instrumentat financiarë të tregtuar në tregjet aktive. Për të gjitha instrumentet e tjera financiare vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur teknika vlerësuese, kryesisht metodën e aktualizimit të fluksit të parasë.

Banka e përcakton vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë e cila reflekton rëndësinë e gjykimeve të përdorura në kryerjen e këtyre matjeve:

Niveli 1: Çmimi tregut të kuotuar (i parregulluar) në një treg aktiv për një instrument identik.

Niveli 2: Teknika vlerësimi në bazë të inputeve të vëzhgueshme, qoftë drejtpërdrejt (p.sh. çmimet) ose indirekt (p.sh. rrjedhoje e çmimeve). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur: çmimet e kuotuar të tregut në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuar për instrumente identike ose të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak se aktiv, ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë direkt ose indirekt të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut. Niveli 3: Teknika vlerësimi që përdorin inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku teknika e vlerësimit përfshin inpute që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe të dhënat jo të vëzhgueshme kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta të cilat janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumenta të ngjashëm ku rregullime apo supozime të rëndësishme jo të vëzhgueshme janë të nevojshme të kryhen në mënyrë që të reflektojnë diferencat midis instrumentave.

##### ***v Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar***

Në çdo datë bilanci, Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk janë vlerësuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur ka evidenca objektive që tregojnë që pas njohjes fillestare të aktivit ka ndodhur një ngjarje që sjell humbje, e cila ka një ndikim në flukset e ardhshme monetare të aktivit të cilat mund të maten me besueshmëri.

Banka i zhvlerëson aktivet e saj si individualisht ashtu edhe në grup. Të gjithë aktivet financiare individualisht të rëndësishme trajtohen për zhvlerësim të veçantë. Të gjithë aktivet e rëndësishme të cilët nuk janë zhvlerësuar në mënyrë të veçantë do të trajtohen në grup për çdo zhvlerësim të ndodhur, por të pa identifikuar ende. Aktivet të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht trajtohen bashkërisht për zhvlerësim duke u grupuar në aktivet financiare (të mbajtura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta rreziku.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijnë

a. Rastet e prishjen së kontratës për shkak të mospagimit të interesave ose kesteve të huase sipas kritereve të mëposhtme:

- Kreditë hipotekore/ për shtëpi më shumë se 90 ditë në vonesë.
- Kreditë hipotekore tregtare, konsumatore, kata krediti, overdrafte individuale më shumë se 90 ditë në vonesë.

- Huatë e biznesit me më shumë se 90 ditë vonesë.
- Huatë të ristruktuara në vitin e parë
- Huatë e ristruktuara jo që në vitin e parë por me vonesa më shumë se 30 ditë.
- Kontaminimi: Kontaminimi për huatë e dhëna individëve aplikohet nëse te paktën një nga huatë është më vonesë më shumë se 180 ditë. Në raste të grupeve të klienteve të huave individuale ose te biznesit, huatë e dyshimta të dhëna individëve nuk kontaminojnë huatë e biznesit.

b. Huatë e klasifikuara në një nga kategoritë “e humbura”, të tilla si dyshimta ose te humbura, pavarësisht numrit të ditëve vonesave (vlerësim cilësor) për shkak të treguesve që një huamarrës ose një huadhënës do të falimentojë, zhdukja e një tregu aktiv për një aktiv financiar specifik për shak të statusit financiar.

- c. Të dhëna të vëzhgueshme të cilat tregojnë se ekziston një rënie e matshme në flukset monetare të vlerësuara nga një grup aktivesh financiare, pavarësisht se rënia nuk mund të identifikohet ende me një aktiv financiar individual në grupin e aktiveve duke përfshirë:
- Ndryshime të kundërta në statusin e pagesave të huamarrësve në grup (p.sh rritja e numrit të pagesave të vonuara ose rritja e numrit e huamarrësve të kartave të kreditit të cilët kanë arritur limitin e kartës së kreditit dhe janë duke paguar shumën minimale mujore), ose
  - Kushtet ekonomike lokale ose ndërkombëtare që janë të lidhura ngushte me vonesat e aktiveve në grup (p.sh rritja e nivelit të papunësisë në zonën gjeografike të huamarrësit, rënie në cmimin e pronave për kreditë hipotekore në zona të ngjashme, rënie në cmimin e naftës për aktivet e marra me kredi nga prodhuesit e naftës ose, ndryshime të pafavorshme në kushtet e industrisë që ndikojnë huamarrësit në grup).

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provigjoni përkundrejt huave dhe parapagimeve. Interesi mbi aktivin e zhvlerësuar vazhdon të njihet nëpërmjet skontimit të pandryshueshëm. Kur një ngjarje pas datës së bilancit shkakton uljen e shumës së humbjes nga zhvlerësimi, zhvlerësimi rimerret përmes fitimit ose humbjes.

Për trajtimin e zhvlerësimit kolektiv (në grup), aktivet financiare grupohen mbi bazën e karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë (p.sh. mbi bazën e procesit të klasifikimit të Bankës që merr në konsideratë llojin e aktivit, industrinë, vendodhjen gjeografike, llojin e kolateralit, statusin pas detyrimit, dhe faktorë të tjerë të përshtatshëm).



Këto karakteristika janë të rëndësishëm për vlerësimin e flukseve monetare të ardhshme për grupe të aktiveve të tilla duke treguar aftësinë e debitorëve për të paguar të gjitha shumat përkatëse sipas kushteve kontraktuale të aktiveve të vlerësuar.

Flukset monetare të ardhshme për një grup aktivesh financiare që zhvlerësohen në grup llogariten mbi bazat e flukseve monetare kontraktuale të aktiveve të Bankës dhe eksperiencës historike të humbjes për aktivet me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kreditsë me ato të Bankës. Eksperiencia historike e humbjes është e rregulluar mbi bazat e të dhënave aktuale të dukshme për të reflektuar efektet e kushteve aktuale që nuk ndikojnë në periudhën në të cilën bazohet eksperiencia historike e humbjes dhe për të hequr efektet e kushteve në periudhën historike që nuk ekziston aktualisht.

Vlerësimet në ndryshimet e flukseve monetare të ardhshme për grupe aktivesh duhet të reflektojnë dhe të jenë drejtëpërdrejtë në përputhje me ndryshimet e të dhënave përkatëse të vëzhgueshme nga periudha në periudhë (për shembull, ndryshimet në normën e papunësisë, çmimet e pasurive të paluajtshme, statusi i pagesës, ose faktorë të tjerë tregues të ndryshimeve në probabilitetin e humbjeve në Grup dhe madhësinë e tyre). Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht nga Banka për të zvogëluar ndryshimet ndërmjet vlerësimeve të humbjes dhe përvojës aktuale të humbjes.

#### **vi Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit për instrumentet financiare të vlefshme për shitje**

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje kur shkaktohen si rezultat i një ose me shume ngjarjeve (“ngjarje humbjesh”) që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të investimit në letrat me vlerë të vlefshme për shitje.

### **(k) Mjetet monetare dhe ekuivalentet dhe pasqyra e fluksit të parasë**

#### **(k.1) Mjetet monetare dhe ekuivalentet**

Mjetet monetare dhe ekuivalentet përfshijnë gjendjen e kartëmonedhave dhe monedhave në arkë, shuma të pakushtëzuara me Bankën Qendrore, hua dhe paradhënie ndaj bankave dhe aktive financiare shumë likuide me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Banka për administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Rezervat e detyrueshme të mbajtura në Bankën Qendrore e vecuar nga mjetet monetare dhe ekuivalentet për qëllime të raportimit të flukseve monetare. Mjetet monetare dhe ekuivalentet mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto të amortizuar.

#### **(k.2) Përgatitja e Pasqyrës së Flukseve Monetare**

Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative në

Pasqyrën e Flukseve Monetare përfshijnë interesat e përlogaritura të aktiveve dhe detyrimeve që mbartin interer. Flukset monetare të përdorura në aktivitet operative për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013 përfshijnë interesin e marrë në shumën LEK 1,274,992 mijë (2012: LEK 1,740,402 mijë) dhe interesat e paguara në shumën ALL 486,341 mijë (2012: LEK 621,361).

#### **(l) Hua dhe të arkëtueshmet**

Huatë dhe të arketueshmet janë aktive financiare joderivative, me pagesa fikse ose të përcaktueshme të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe që Banka nuk ka për qëllim t'i shesë menjëherë ose në një periudhë të afërt. Në rastet që Banka blen një aktiv financiar dhe njëkohësisht nënshkruan një marrëveshje për të rishitur këtë aktiv (ose një aktiv thelbësisht të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (“marrëveshje të anasjellta të riblerjes”), marrëveshja kontabilizohet si hua ose paradhënie ndaj bankave të tjera ose klientëve. Diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të riblerjes trajtohet si interes dhe përlogaritet mbi jetëgjatësinë e marrëveshjeve duke përdorur metodën efektive të interesit. Huatë dhe paradhëniet fillimisht llogariten në vlerën e drejtë plus kostot rritëse direkte të transaksionit, dhe në vijim llogariten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### **(m) Investime në letra me vlerë**

Investimet në letrat me vlerë njihen fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot direkte të transaksionit që lidhen me të dhe në vijim kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre si të mbajtura deri në maturim, ose të vlefshme për shitje.

Instrumentat financiarë të mbajtur deri në maturim Investimet në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim janë aktive me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me maturim të përcaktuar që Banka ka synimin pozitiv dhe mundësinë për ti mbajtur deri në maturim, dhe të cilat nuk janë regjistruar me vlerën e drejtë nëpërmjet humbjes ose fitimit ose si të disponueshme për shitje. Investimet në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim regjistrohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Çdo shitje ose riklasifikim i një shume të konsiderueshme të investimeve në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim jo afër maturimit të tyre do të rezultonte në riklasifikimin e instrumentave të mbajtur deri në maturim si të vlefshme për shitje, dhe do ta ndalonte Bankën për klasifikimin e tyre si investim i mbajtur deri në maturim për vitin financiar aktual dhe dy vitet financiarë pasues.

Instrumentat financiarë të vlefshme për shitje Investimet e vlefshme për shitje janë investime jo-derivative që nuk trajtohen si një kategori tjetër e aktiveve financiare. Investimet e kapitalit të pakuotuar, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme,

mbarten me kosto. Të gjitha investimet e tjera të vlefshme për shitje mbarten me vlerë të drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit në investimet e borxhit të vlefshme për shitje njihen në humbje ose fitim.

Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse deri kur investimi të jetë shitur ose zhvlerësuar dhe teprica në kapital riklasifikohet nga të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në fitim ose humbje.

### **(n) Aktivet afatgjata materiale**

#### **i Njohja dhe matja**

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë të matura me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi.

Kostoja përfshin shpenzimet të cilat lidhen drejtpërsëdrejti me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë Banka përfshin koston e materialeve dhe fuqisë punëtore, si dhe çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në gjendje pune sipas synimit të përdorimit, dhe kostot e cmontimit dhe kthimit të ambjentit në kushtet e duhura. Kur pjesë të ndryshme të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të vecantë (komponentë kryesor) të aktiveve afatgjata materiale.

#### **ii Kostot vijuese**

Kostoja e pjesëve zëvendësuese të një zëri të aktiveve aftagjata materiale njihet me vlerën e mbartur të atij zëri nëse është e mundshme që në të ardhmen Banka do të këtë përfitime ekonomike nga këto pjesë dhe kostot e tyre mund të njihen në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

#### **iii Amortizimi**

Amortizimi njihet në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve me anën e metodës lineare mbi jetën e dobishme të vlerësuar të çdo pjese të një aktiviteti afatgjatë material. Aktivet e marra me qira amortizohen për periudhën më të shkurtër ndërmjet periudhës sipas kontratës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivitetit. Toka nuk amortizohet. Jeta e dobishme e çmuar është si më poshtë:

	(në vite)
Ndërtesa	40
Kompjuterat dhe pajisjet elektronike	4
Mobilje dhe pajisje zyre	5
Automjete	5
Përmirësimet e ambienteve të marra me qira	9 - 12

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit.

### **(o) Aktivet afatgjata jomateriale**

Programe kompjuterike të blerë nga Banka pasqyrohen me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Shpenzimet e mëvonshme për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet ekonomike në të ardhmen të cilat rrjedhin nga aktiviteti specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera regjistrohen si shpenzime korrente në momentin që ndodhin.

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve bazuar në metodën lineare të amortizimit përgjatë jetës së dobishme ekonomike të programit kompjuterik, nga data që ai aktivitet është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e vlerësuar e programeve kompjuterike është katër vjet.

### **(p) Aktivet afatgjatë të mbajtur për shitje**

Aktive të mbajtura për shitje përfaqësojnë aktivet afatgjata që nuk janë përdorur për qëllime operationale por do të rikuperohen nëpërmjet një transaksioni shitjeje. Këto aktive janë përfshirë nëpërmjet ekzekutimit të kolateraleve të vendosura për huatë dhe paradhëniet. Aktivet afatgjata të klasifikuara si të mbajtura për shitje njihen me vlerën më të ulët mes koston historike dhe vlerës së drejtë minus shpenzimet e shitjes. Këto aktive janë përfshirë në “Aktive të tjera” në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

### **(q) Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare**

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikupërueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit ose një pjesë e tij e gjenerimit të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikupërueshme. Një pjesë gjeneruese e

mjeteve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të parvarur nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në humbje ose fitim.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuarat monetare të ardhshme janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në cdo datë raportimi për ndonjë indikacion nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi rimerret deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

#### **(r) Depozitat dhe detyrime të tjera financiare**

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë burimet e Bankes për fondin e borxhit. Kur Banka shet një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë hyn në një marrëveshje riblerje për të riblerë aktivin (ose një aktiv të njëjtë) me një çmim të pandryshuar në një datë të mëvonshme, marrëveshja do të njihet si depozitë, dhe aktivi në fjalë do vazhdojë të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Banka klasifikon instrumentat e kapitalit si detyrime financiare ose instrumente kapitali në përputhje me kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një Instrument kapitalit është cdo kontratë që paraqet një interes të mbetur në një aktiv të Bankës pasi zbriten të gjitha detyrimet e tij. Instrumentat e kapitalit të emetuara nga Banka njihen në të ardhura të marra, neto nga koston direkte.

Një detyrim financiar është cdo detyrim i cili është

(a) një detyrim kontraktual për transferimin e mjeteve monetare ose aktiveve të tjera tek një njësi ekonomike tjetër; ose të këmbëjë aktive financiare ose detyrime financiare me një njësi ekonomike tjetër sipas kushteve të pafavorshme për njësinë ekonomike; ose

(b) një kontratë që mund ose të kompesohet me instrumentat e kapitalit të njësisë ekonomike.

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë duke shtuar koston e transaksionit, dhe njihet në vazhdimësi me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### **(s) Provigjonet**

Një provigjon është njohur nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provigjonet maten duke skontuar flukset e ardhshme të mjeteve monetare për shlyerjen e detyrimit, me normën e skontimit para tatimit që reflekton vlerën në kohë të parasë sipas vlerësimeve aktuale të tregut, dhe kur është e nevojshme, rreziqet që lidhen me këtë detyrim.

#### **(t) Informacioni krahasues**

Të dhëna krahasuese janë riklasifikuar kur ka qënë e nevojshme, në përputhje me ndryshimet në prezantimin në periudhën aktuale. Megjithatë, këto riklasifikime nuk kanë rezultuar në ndryshime të rëndësishme të përmbajtjes dhe paraqitjes e informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare.

Në periudhën aktuale, provigjonet për humbjet nga kreditë janë paraqitur të ndara nga provigjonet e tjera në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Si pasojë “Provigjonet për humbjet nga kreditë, neto” për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012 me vlerën LEK 972,806 mijë janë riklasifikuar gjithashtu në Humbje nga zhvlerësimi i kredive, paradhënieve dhe letër garancive në shumën LEK 972,806 mijë dhe Riskun Operacional dhe Kosto të Tjera të Riskut në vlerën LEK 10,162 mijë.

#### **Zhvlerësimi i humbjeve nga kreditë**

Banka rishikon portofolin e saj të kredisë për të vlerësuar zhvlerësimin, të paktën një herë në muaj. Për të përcaktuar nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të pasqyrohet në humbje ose fitim, Banka gjykon nëse ka të dhëna të dukshme që tregojnë se ekziston një rënie e matshme në flukset e

ardhshme të mjeteve monetare të parashikuara nga portfoli kredive përpara se rënia të mund të identifikohet me një kredi individuale në atë portfol. Kjo evidence mund të përfshijë të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se është bërë një ndryshim i pafavorshëm në gjendjen e pagesave të huamarrësve në një grup, ose në kushtet ekonomike kombëtare ose vendore, që lidhen me mospagesa për aktivet në grup.

Drejtimi përdor vlerësime në bazë të përvojës historike të

## 4. Menaxhimi i rrezikut

#### **Një vështrim i përgjithshëm**

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozon Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset e Bankës për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

#### **Struktura e administrimit të rrezikut**

Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësi të përgjithshme për vendosjen dhe për mbikëqyrjen e strukturës së menaxhimit të rrezikut të Bankës. Bordi ka krijuar Komitetin e Rrezikut të Kredisë dhe Operacional të Aktiveve dhe Detyrimeve të Bankës (ALCO), të cilët kanë përgjegjësi për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të rrezikut të Bankës në fushat e tyre specifike. Të gjithë komitetet e Bordit kanë anëtarë ekzekutivë dhe jo ekzekutivë dhe raportojnë rregullisht tek Bordi i Drejtorëve për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Bankës janë vendosur që të dallojnë dhe të analizojnë rreziqet që përballen nga Banka, që të vendosin limite dhe kontrole të përshtatshme të rreziqeve, dhe që të monitorojnë rreziqet dhe zbatimin e kufijve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara Banka, përmes standardeve dhe procedurave të trajnimit dhe të menaxhimit synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe të strukturuar, ku të gjithë punonjësit janë në dijeni për rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditit të Bankës ka përgjegjësi për monitorimin e përmbushjes së politikave dhe procedurave të menaxhimit të rrezikut të Bankës dhe për rishikimin e përshtatshmërisë së strukturës së menaxhimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Banka. Komiteti i Auditimit

humbjes për aktivet me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe me evidenca objektive të zhvlerësimit, të ngjashme me ato në portfol kur planifikon flukset e tij të ardhshme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të llogaritur si shumën ashtu edhe kohën e flukseve të ardhshme të parasë, janë rishikuar rregullisht për të ulur ndonjë diferencë midis vlerësimeve të humbjes dhe eksperiencës aktuale të humbjes.

të Bankës asistohet në këto funksione nga Auditit i Brendshëm. Auditit i Brendshëm kryen rishikime të rregullta dhe të posaçme të kontrollit të procedurave të menaxhimit të rrezikut, rezultatet e të cilave i raportohen Komitetit të Auditit.

#### **(b) Rreziku i kredisë**

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Bankës në rast se një klient ose pala tjetër e një instrumenti financiar nuk përmbush detyrimet e tij kontraktuale, dhe buron kryesisht nga huatë dhe paradhëniet e klientëve dhe investimeve në letra me vlerë dhe të tjera të Bankës. Për qëllime raportuese të menaxhimit të rrezikut, Banka merr parasysh dhe konsolidon të gjitha elementet e ekspozimit të rrezikut të kredisë (si rreziku i mospërmbushjes së detyrimit individual, rreziku shtetëror ose i sektorit).

#### **Menaxhimi i rrezikut të kredisë**

Bordi i Drejtorëve ka deleguar përgjegjësi për administrimin e rrezikut të kredisë tek Komiteti i Kredisë së Bankës. Një njësi e veçantë e Bankës, që raporton te Drejtorit Ekzekutiv dhe paralelisht Drejtorit të Risqeve, ka përgjegjësi për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë së Bankës. Menaxhimi i rrezikut të kredisë realizohet përmes:

Krijimit të politikave të rrezikut të kredisë në konsultim me njësitë e biznesit, kërkesat për mbulimin e kolateralit, vlerësimin e kredieve, përshkallëzim dhe raportim rreziku, procedura të shkruara dhe ligjore, dhe përputhje me kriteret rregullatore dhe ligjore.

Vendosjes dhe monitorimit të niveleve të delegimit dhe procesit të shkallëzimit në lidhje me miratimet e kredisë. Bordi i Drejtorëve delegon kompetencën e tij prej autoriteti të miratimit tek Komitetet e Kredisë së Bankës, aktualisht për shumën deri në 2,000,000 Euro dhe ekuivalentët e saj. Megjithatë për financimin e sektorëve të veçantë të ekonomisë si edhe të llojeve të tjerë të palëve, që konsiderohen më shumë të rrezikshëm, siç janë pasuritë e patundshme, ndërtime, hotelet, fillimet e aktivitetit, institucionet financiare, personat politikë, etj., autoriteti miratues mbetet në



Bordin e Drejtorëve pavarësisht shumës së financimit. Rishikimit dhe vlerësimit të rrezikut të kredisë. Menaxhimi i Bankës dhe Sektori i Kontrollit të Përhershëm të Bankës vlerëson të gjithë kufijtë e ekspozimit të kredisë, përpara miratimit përfundimtar nga autoriteti kompetent. Rinovimet dhe rishikimet e huave janë subjekt i po të njëjtit proces. Kufizimi i përqëndrimit të ekspozimit ndaj kundërpartive, qofshin përqëndrime gjeografike apo sektoriale të ekonomisë.

Banka strukturon nivelet e rrezikut të kredisë që ajo merr përsipër duke vendosur kufij në shumën e rrezikut të pranuar në lidhje me një huamarrës, ose me një grup huamarrësish, segmente industriale dhe segmente gjeografike. Këto rreziqe vëzhgohen në një bazë të përsëritshme dhe janë subjekt i një rishikimi vjetor ose më të shpeshte, kur gjykohet e nevojshme.

Monitorimit të shpeshtë të ekspozimeve aktuale kundrejt limiteve. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë menaxhohet gjithashtu përmes analizës së rregullt të aftësisë së Banka klasifikon kreditë sipas kategorive të risqeve të mëposhtme:

Të arkëtueshme pa vonesa	Standarte	Ditëvonesa <=30 ditë
Të arkëtueshme sensitive	Në ndjekje	31 < Ditëvonesa <= 60 ditë
Të arkëtueshme sensitive	Nënstandarte	61 < Ditëvonesa <=90 ditë
Të arketueshme të dyshimta te pakompromentuara	Të dyshimta	91 < Ditëvonesa <= 365 ditë
Të arketueshme të dyshimta te kompromentuara	Të humbura	Ditëvonesa > 365 ditë

Kreditë e klasifikuara në 3 kategoritë e para konsiderohen si kredi pa probleme. Kreditë e dy kategorive të tjera konsiderohen si kredi të këqija. Përvet kriterit të ditëvonesave, të paraqitura më sipër, banka gjithashtu përdor kriteret cilësore të mëposhtme për përcaktimin e kategorizimin e rrezikut të kredive:

- Aftësia paguese
- Kushtet financiare
- Aftësite menaxhuese
- Struktura e kredive
- Industria dhe ekonomia

Kreditë me kushte të rinegociueshme janë kredi që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit dhe ku bank ka rënë në konsensus që kjo gjë nuk do të konsiderohet. Kreditë me kushte të rinegociueshme janë konsideruar si të zhvlerësuar individualisht: a) Në vitin e parë që nga implementimi i ristrukturimit b) pas vitit të parë, kur ka më shumë se 30 ditë vonesa.

### (i) Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë

	Ekspozimi Maksimal Bruto	
	31 Dhjetor 2013 ALL '000	31 Dhjetor 2012 ALL '000
<b>Ekspozimet e rrezikut të kredisë lidhur me</b>		
<b>aktivet e bilancit janë si vijojnë:</b>		
Hua dhe paradhënie bankave	5,725,950	5,802,129
Hua dhe paradhënie për klientët:		
<b>Huatë për individët</b>		

huamarrësve dhe potencialit të huamarrësve për të përmushur detyrimet e interesit dhe të ripagesës së kapitalit, edhe duke ndryshuar këto limite kreditimi kur është e përshtatshme.

Zhvillimit dhe përdorimit të sistemit të vlerësimit të rrezikut të Bankës për të kategorizuar ekspozimin sipas shkallës së rrezikut të humbjes financiare dhe për të fokusuar drejtimin në rreziqet aktuale të Bankës. Sistemi i kategorizimit të rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur mund të kërkohet provigjoni për zhvlerësime kundrejt ekspozimeve specifike ndaj rrezikut të kredisë.

Struktura aktuale e klasifikimit të rrezikut konsiston në pesë kategori që pasqyrojnë shkallë të ndryshme të rrezikut të mospagjit dhe disponueshmërisë së kolateralit ose rreziqe të tjera krediti. Përgjegjësia e vendosjes së shkallëve të rrezikut mbetet tek Njësia e Kontrollit të Përhershëm dhe e Menaxhimi i Rrezikut me miratimin përfundimtar të Komitetit të Kredisë. Shkallët e rrezikut janë subjekt i rishikimeve të rregullta nga Banka.

– Overdrafte	958,663	1,329,069
– Kredi me afat	6,785,423	7,788,876
<b>Huatë për korporata</b>		
– Overdrafte	4,553,163	4,372,445
– Kredi me afat	5,018,061	5,924,782
<b>Totali huave dhe paradhënies për klientët</b>	<b>17,315,310</b>	<b>19,415,172</b>
Investime financiare të vlefshme për shitje	983,609	851,926
Aktive të tjera financiare	159,967	76,593
	<b>18,458,886</b>	<b>20,343,691</b>
<b>Ekspozimet ndaj rrezikut të kredive lidhur me zërat jashtë bilancit janë si vijojnë:</b>		
Letra Garancie	586,358	465,385
Angazhime të kredive	580,834	483,944
	<b>1,167,192</b>	<b>949,329</b>
<b>Më 31 Dhjetor</b>	<b>25,352,028</b>	<b>27,095,149</b>

Tabela më poshtë paraqet ekspozimin neto të huave dhe paradhënies për klientët më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012, kategorizuar sipas zhvlerësimit individual dhe kolektiv të portofolit:

	Ekspozimi neto i huave dhe paradhënies për klientët	
	31 Dhjetor 2013 ALL '000	31 Dhjetor 2012 ALL '000
<b>Kredi të zhvlerësuar individualisht</b>		
Vlera bruto	7,883,756	7,457,459
Fondi për humbjet nga zhvlerësimi i kredive	(3,660,696)	(3,454,733)
<b>Vlera kontabël</b>	<b>4,223,060</b>	<b>4,002,726</b>
<b>Kredi të zhvlerësuar në nivel portofoli</b>		
Vlera bruto	13,385,354	15,833,539
Fondi për humbjet nga zhvlerësimi i kredive	(293,104)	(421,093)
<b>Vlera kontabël</b>	<b>13,092,250</b>	<b>15,412,446</b>
<b>Totali vlerës kontabël të huave dhe paradhënies për klientët</b>	<b>17,315,310</b>	<b>19,415,172</b>

	31 Dhjetor 2013 ALL '000		31 Dhjetor 2012 ALL '000	
<b>Hua dhe paradhënie bankave</b>				
<i>As me vonesë, as të zhvlerësuar</i>				
Standarte	5,725,950		5,802,129	
Marreveshje REPO	-		-	
<b>Totali i vlerës kontabël</b>	<b>5,725,950</b>		<b>5,802,129</b>	
<b>Aktive financiare të vlefshme për shitje</b>				
<i>As me vonesë, as të zhvlerësuar</i>				
Standard	983,609		851,926	
<b>Totali i vlerës kontabël</b>	<b>983,609</b>		<b>851,926</b>	



**(ii) Cilësia kreditore e huave dhe paradhënieve ndaj bankave dhe investimeve ne letra me vlerë**

Tabela më poshtë paraqet cilësinë kreditore të huave dhe paradhënieve ndaj bankave dhe investimeve në letra me vlerë:

	Hua dhe paradhënie ndaj bankave		Aktive financiare të vlefshme për shitje	
	31/12/2013	31/12/2012	31/12/2013	31/12/2012
	ALL '000	ALL '000	ALL '000	ALL '000
<b>As me vonesë, as të zhvlerësuara</b>				
Shkalla 1: Risk i ulët (Standart)	5,725,950	5,802,129	983,609	851,926
<b>Totali i vlerës kontabël (Shënimi 7 dhe 8)</b>	<b>5,725,950</b>	<b>5,802,129</b>	<b>983,609</b>	<b>851,926</b>

**(iii) Cilësia kreditore e huave dhe paradhënieve për klientët**

	Hua dhe paradhënie për klientët	
	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
	ALL '000	ALL '000
<b>Vlera kontabël</b>		
<b>Kredi të zhvlerësuara individualisht</b>		
Shkalla 1: Të zhvlerësuara (Standarde)	-	-
Shkalla 2: Të zhvlerësuara (Në ndjekje)	-	-
Shkalla 3: Të zhvlerësuara (Nënstandarte)	-	-
Shkalla 4: Të zhvlerësuara (Të dyshimtë)	3,591,349	3,632,366
Shkalla 5: Të zhvlerësuara (Të humbura)	4,292,407	3,825,093
<b>Vlera bruto</b>	<b>7,883,756</b>	<b>7,457,459</b>
Fondi për humbjet nga zhvlerësimi i kredive	(3,660,696)	(3,454,733)
<b>Vlera kontabël (A)</b>	<b>4,223,060</b>	<b>4,002,726</b>
<b>Kredi të zhvlerësuara ne nivel portofoli</b>		
Shkalla 1: Risk i ulët (Standarte)	5,182,934	9,925,972
Shkalla 2: (Në ndjekje)	6,884,775	4,608,008
Shkalla 3: Të zhvlerësuara (Nënstandarte)	1,247,624	1,221,374
Shkalla 4: Të zhvlerësuara (Të dyshimta)	47,056	49,870
Shkalla 5: Të zhvlerësuara (Të humbura)	22,965	28,314
<b>Vlera bruto</b>	<b>13,385,354</b>	<b>15,833,538</b>
Fondi për humbjet nga zhvlerësimi i kredive	(293,104)	(421,092)
<b>Vlera kontabël (B)</b>	<b>13,092,250</b>	<b>15,412,446</b>
<b>Totali vlera kontabël (A+B)</b>	<b>17,315,310</b>	<b>19,415,172</b>

Huatë dhe paradhëniet janë si vijonë:

	31 Dhjetor 2013		31 Dhjetor 2012	
	Hua dhe paradhënie klientëve	Hua dhe paradhënie bankave	Hua dhe paradhënie klientëve	Hua dhe paradhënie bankave
	ALL '000	ALL '000	ALL '000	ALL '000
As me vonesë, as të zhvlerësuara	8,489,346	5,725,950	8,829,214	5,802,129
Detyrime të prapambetura por jo të zhvlerësuara	3,578,363	-	5,704,766	-
Të zhvlerësuara	9,201,401	-	8,757,017	-
<b>Totali burto</b>	<b>21,269,110</b>	<b>5,725,950</b>	<b>23,290,997</b>	<b>5,802,129</b>
Minus: Fondi për humbjet nga zhvlerësimi i kredive	(3,953,800)	-	(3,875,825)	-
<b>Totali Neto</b>	<b>17,315,310</b>	<b>5,725,950</b>	<b>19,415,172</b>	<b>5,802,129</b>

**(iv) Hua dhe paradhënie as me vonesë, as të zhvlerësuara sipas kategorisë së zhvlerësimit (vlerat bruto)**

31 Dhjetor 2013	Individet		Korporata		Totali	
	Overdraft	Hua me afat	Overdraft	Hua me afat	Hua dhe paradhënie klientëve	Hua dhe paradhënie ndaj bankave
	ALL '000	ALL '000	ALL '000	ALL '000	ALL '000	ALL '000
Monitorim Standard	568,086	3,406,025	42,168	-	4,016,279	5,725,950
Monitorim Special	71,399	77,900	2,893,620	1,430,148	4,473,067	-
Nën-standarde	-	-	-	-	-	-
Të dyshimta	-	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>639,485</b>	<b>3,483,925</b>	<b>2,935,788</b>	<b>1,430,148</b>	<b>8,489,346</b>	<b>5,725,950</b>

31 December 2012	Individet		Korporata		Totali	
	Overdraft	Hua me afat	Overdraft	Hua me afat	Hua dhe paradhënie klientëve	Hua dhe paradhënie ndaj bankave
	ALL '000	ALL '000	ALL '000	ALL '000	ALL '000	ALL '000
Monitorim Standard	694,689	3,831,807	1,147,152	1,836,684	7,510,332	5,802,129
Monitorim Special	2,627	38,170	598,180	679,905	1,318,882	-
Nën-standarde	-	-	-	-	-	-
Të dyshimta	-	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>697,316</b>	<b>3,869,977</b>	<b>1,745,332</b>	<b>2,516,589</b>	<b>8,829,214</b>	<b>5,802,129</b>

**(v) Hua dhe paradhënie të vonuara por jo të zhvlerësuar**

31 Dhjetor 2013	Individ		Korporata		Totali
	Overdraft	Hua me afat	Overdraft	Hua me afat	
	ALL '000	ALL '000	ALL '000	ALL '000	ALL '000
Me vonesë deri në 30 ditë	183,353	1,253,057	1,025,079	706,182	3,167,671
Me vonesë 30 – 90 ditë	11,951	346,912	-	46,513	405,376
Me vonesë 90 – 180 ditë	-	-	-	-	-
Me vonesë më shumë se 180 ditë	235	5,081	-	-	5,316
<b>Totali</b>	<b>195,539</b>	<b>1,605,050</b>	<b>1,025,079</b>	<b>752,695</b>	<b>3,578,363</b>
<b>Vlera e drejtë e kolateraleve</b>	<b>334,500</b>	<b>4,194,096</b>	<b>2,248,084</b>	<b>4,165,898</b>	<b>10,942,578</b>

31 Dhjetor 2012	Individ		Korporata		Totali
	Overdraft	Hua me afat	Overdraft	Hua me afat	
	ALL '000	ALL '000	ALL '000	ALL '000	ALL '000
Me vonesë deri në 30 ditë	262,198	1,462,352	1,415,135	1,072,345	4,212,030
Me vonesë 30 – 90 ditë	2,036	317,273	818,672	354,756	1,492,737
Me vonesë 90 – 180 ditë	-	-	-	-	-
Me vonesë më shumë se 180 ditë	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>264,234</b>	<b>1,779,625</b>	<b>2,233,807</b>	<b>1,427,101</b>	<b>5,704,766</b>
<b>Vlera e drejtë e kolateraleve</b>	<b>202,629</b>	<b>5,558,067</b>	<b>1,582,794</b>	<b>7,975,448</b>	<b>15,318,939</b>

Huate dhe letrat me vlerë me vonesë por jo të zhvlerësuar përmbajnë kredi ku interesat kontraktuale ose pagesat e kësteve janë me vonesë por Banka beson se zhvlerësimi nuk është i përshatshëm në bazë të nivelit të sigurisë / vlefshmërisë së kolateralit dhe / ose fazes së mbledhjes së shumave të fituara nga Banka.

**(vi) Hua dhe paradhënie të zhvlerësuar**

31 Dhjetor 2013	Individ		Korporata		Totali
	Overdrafte	Hua me afat	Overdrafte	Hua me afat	
	LEK '000	LEK '000	LEK '000	LEK '000	LEK '000
Kredi të zhvlerësuar individualisht	342,433	2,685,693	943,649	3,911,981	7,883,756
Kredi të zhvlerësuar kolektivisht	26,848	631,358	132,230	527,209	1,317,645
<b>Vlera e drejtë e kolateraleve</b>	<b>564,836</b>	<b>7,181,182</b>	<b>2,701,509</b>	<b>18,169,927</b>	<b>28,617,454</b>
<b>31 Dhjetor 2012</b>					
Kredi të zhvlerësuar individualisht	405,658	2,780,142	796,907	3,474,752	7,457,459
Kredi të zhvlerësuar kolektivisht	205,338	993,052	-	101,168	1,299,558
<b>Vlera e drejtë e kolateraleve</b>	<b>727,842</b>	<b>9,115,024</b>	<b>1,165,537</b>	<b>15,230,213</b>	<b>26,238,616</b>

Kreditë me kushte të rinegociuara  
 Kredi me kushte të rinegociuara janë kredi që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit dhe kur Banka ka bërë marrveshje që në kundërt nuk do i merrte në konsideratë. Me ristrukturimin e kredisë, kjo e fundit qëndron në këtë kategori, e pavarur nga performanca e kënaqshme pas ristrukturimit. Shuma totale e kredive të rinegociuara më 31 Dhjetor 2013 është 3,341,944 mijë Lek (31 Dhjetor 2012: 1,873,623 mijë Lek.)

Provizione për zhvlerësimin  
 Banka krijon një rezervë për humbjet nga zhvlerësimi që përfaqësojnë vlerësimin e saj lidhur me humbjet e shkaktuara në portofolin e kredisë. Përbërësit kryesorë të këtyre provizionit janë komponenti i humbjeve specifike që lidhen me ekspozimet e rëndësishme individuale dhe një provigjoni kolektiv i kredive i logarituar për grupet e aktiveve të ngjashme në lidhje me humbjet e realizuara por që nuk janë identifikuar në huatë që janë subjekt i vlerësimit individual për zhvlerësimin.

Politika e fshirjes  
 Banka fshin balancën e një kredie/letër me vlerë (dhe çdo provigjion për humbjet nga

zhvlerësimi të lidhur me të) kur Komiteti i Kredisë së Bankës vendos që kreditë/letrat me vlerë janë të pambledhshme. Ky vendim arrihet pas marrjes në konsideratë të informacionit të tillë si ndodhja e ndryshimeve të rëndësishme në pozitën financiare të huamarrësit/ huadhënësit në mënyrë që huamarrësi/huadhënësi nuk mund të paguajë më detyrimin, të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të kompensuar të gjithë ekspozimin. Për kreditë me vlerë më të vogël të standartizuara vendimet për fshirjen, bazohen në statusin e mëparshëm të një produkti specifik si edhe në veprimet ligjore të ndjekura për procedurën e zbatimit.

Më poshtë është një analizë e shumave bruto dhe neto (për provigjionin e zhvlerësimit) të aktiveve të zhvlerësuar individualisht sipas kategorisë së rrezikut. Banka zotëron kolateral kundrejt kredive dhe paradhënieve për klientët. Banka zbaton udhëzimet e saj të brendshme mbi pranueshmërinë e klasave specifike të kolateraleve ose rrezikut të kredisë. Banka zotëron kolateral kryesisht në formën e: Hipotekave të pasurisë së paluajtshme mbi pronat e banimit si edhe të biznesit; Pengjeve mbi aktivet në funksionim të bizneseve të tilla si makineri dhe pajisje, inventare dhe logarive të arkëtueshme;

Para të bllokuara dhe letra me vlerë (p.sh. Bono Thesari), etj.  
 Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e

huamarjes dhe përgjithësisht përditësohen mbi baza vjetore për kreditë e dhëna për klientët e korporatave, ndërsa për ndërmarrjet e vogla dhe për kreditë hipotekore, rishikimi ndodh kur kredia vlerësohet individualisht si e zhvlerësuar, përveç rasteve kur rishikimi kërkohet nga klienti, kredia është e vonuar ose ka një rënie domethënëse në çmimet e tregut për pronat e pasurive të paluajtshme.

Për qëllimin e llogaritjes së zhvlerësimit individual të Kredive dhe paradhënies ndaj Klientëve, kolateralët që janë marrë në konsideratë për llogaritjen e zhvlerësimit janë vetëm pasurive të paluajtshme, paratë të bllokuara dhe garancitë bankare. Kolateralët si aktivet e lëvizshme, të drejtat mbi kontrata qeraje dhe kontrata bashkëpunimi, garanci nga biznese, të drejta mbi llogaritë e arkëtueshme, ceqë, etj, nuk janë marrë në konsideratë pavarësisht faktit që janë marrë si kolateral nga Banka.

Nuk ka kolterale mbi huatë dhe paradhëniet ndaj bankave përveç marrëveshjeve të riblerjes të anasjelltja. Për pjesë me të madhe të portofolit të kredisë vlera e drejtë e kolateralit tejkalon shumën e kredive megjithatë, Banka normalisht e ul vlerën e drejtë të kolateralit kryesisht (rreth 40%) që të raportojnë për vështirësitë praktike dhe administrative të një kolaterali. Në këtë mënyrë Banka mbrohet nga mospagesat e mundshme nga klienti.

	Individët		Korporata		Totali	
	Overdrafte LEK '000	Hua me afat LEK '000	Overdrafte LEK '000	Hua me afat LEK '000	Të zhvlerësuar LEK '000	Vlera e drejtë e kolateraleve LEK '000
<b>31 Dhjetor 2013</b>						
Shkalla 1: Risk i ulët (Standarte)	-	-	-	-	-	-
Shkalla 2: ( Në ndjekje)	-	-	-	-	-	-
Shkalla 3: Të zhvlerësuar (Nënstandarde)	20,429	567,756	132,230	527,209	1,247,624	3,415,017
Shkalla 4: Të zhvlerësuar (Të dyshimtë)	50,886	808,405	383,011	2,396,102	3,638,404	14,458,311
Shkalla 5: Të zhvlerësuar (Të humbura)	297,966	1,940,889	560,638	1,515,880	4,315,373	10,744,125
<b>Totali</b>	<b>369,281</b>	<b>3,317,050</b>	<b>1,075,879</b>	<b>4,439,191</b>	<b>9,201,401</b>	<b>28,617,454</b>

	Individët		Korporata		Totali	
	Overdrafte LEK '000	Hua me afat LEK '000	Overdrafte LEK '000	Hua me afat LEK '000	Të zhvlerësuar LEK '000	Vlera e drejtë e kolateraleve LEK '000
<b>31 Dhjetor 2012</b>						
Shkalla 1: Risk i ulët (Standarte)	-	-	-	-	-	-
Shkalla 2: ( Në ndjekje)	-	-	-	-	-	-
Shkalla 3: Të zhvlerësuar (Nënstandarde)	196,318	923,888	-	101,167	1,221,373	3,109,143
Shkalla 4: Të zhvlerësuar (Të dyshimtë)	51,629	865,879	260,799	2,503,930	3,682,237	15,406,385
Shkalla 5: Të zhvlerësuar (Të humbura)	363,049	1,983,427	536,109	970,822	3,853,407	7,723,088
<b>Totali</b>	<b>610,997</b>	<b>3,773,194</b>	<b>796,907</b>	<b>3,575,919</b>	<b>8,757,017</b>	<b>26,238,616</b>

Banka monitoron përqëndrimin e riskut të kredisë sipas sektorëve dhe vendndodhjeve gjeografike. Një analizë e përqëndrimit të riskut të kredisë më 31 Dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012 tregohet më poshtë:

Përqëndrimi sipas sektorit

	Huatë dhe paradhëniet ndaj klientët		Huatë dhe paradhëniet ndaj bankave		Investimet në letra me vlerë	
	31/12/2013 LEK '000	31/12/2012 LEK '000	31/12/2013 LEK '000	31/12/2012 LEK '000	31/12/2013 LEK '000	31/12/2012 LEK '000
<b>Vlera Kontabël</b>						
Korporata	9,571,224	10,297,227	-	-	-	-
Qeveri	-	-	-	-	983,609	851,926
Banka	-	-	5,725,950	5,802,129	-	-
Individë	7,744,086	9,117,945	-	-	-	-
<b>Total</b>	<b>17,315,310</b>	<b>19,415,172</b>	<b>5,725,950</b>	<b>5,802,129</b>	<b>983,609</b>	<b>851,926</b>

Përqëndrimi sipas vendndodhjes

	Huatë dhe paradhëniet ndaj klientët		Huatë dhe paradhëniet ndaj bankave		Investimet në letra me vlerë	
	31/12/2013 LEK '000	31/12/2012 LEK '000	31/12/2013 LEK '000	31/12/2012 LEK '000	31/12/2013 LEK '000	31/12/2012 LEK '000
<b>Vlera Kontabël</b>						
Shqipëria	17,315,310	19,415,172	1,152,780	252,696	983,609	851,926
Amerika e Veriut	-	-	511,384	592,542	-	-
Europë	-	-	4,061,786	4,956,891	-	-
<b>Totali</b>	<b>17,315,310</b>	<b>19,415,172</b>	<b>5,725,950</b>	<b>5,802,129</b>	<b>983,609</b>	<b>851,926</b>

Përqëndrimi sipas vendndodhjes për kreditë dhe paradhëniet matet duke u bazuar në vendndodhjen e entitetit të Bankës që mban aktivin, i cili ka një lidhje të ngushtë me vendndodhjen e huamarrësit. Përqëndrimi sipas vendndodhjes për investimet në letra me vlerë matet bazuar në vendndodhjen e emetuesit të letrës me vlerë.



Detajimi i huave dhe paradhënjeve ndaj korporatave në lidhje me sektorin ekonomik është si më poshtë:

	Hua dhe paradhënie ndaj korporatave	
	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
	ALL '000	ALL '000
Tregtia, riparimi i makinave dhe shtëpive	3,689,364	3,457,811
Ndërtimi	1,754,452	2,017,671
Prodhimi dhe shpërndarja e elektricitetit, gazit dhe ujit	1,070,867	1,321,506
Industria e përpunimit	961,778	1,045,995
Transporti dhe telekomunikacioni	351,564	359,050
Aktivitetet sociale dhe shëndetësore	287,564	304,681
Shërbimet individuale dhe sociale, publike	920,094	929,056
Hotelet dhe restorantet	130,536	115,012
Gjuetia, agrikultura dhe shërbime të tjera	122,003	339,893
Peshkimi, kultivimi i peshkut dhe kulturat ujore	205,094	222,658
Industria tekstile	-	51,007
Pasuri të patundshme	77,908	132,887
<b>Total</b>	<b>9,571,224</b>	<b>10,297,227</b>

## Rreziku i shlyerjes

Aktivitetet e Bankës mund të shkaktojnë rrezik në momentin e shlyerjes së transaksioneve dhe tregtimeve. Rreziku i shlyerjes është rreziku i humbjeve për shkak të dështimit të një shoqërie në përmbushjen e detyrimeve të saj për të dhënë mjete monetare, letra me vlerë ose aktive të tjera ashtu sic është rënë dakort në kontratë.

Për disa transaksione të vecanta Banka mund të zvogëlojë këtë rrezik duke bërë shlyerje nëpërmjet agjentit të shlyerjes/ kleringut për të siguruar që një transaksion është shlyer kur të dyja palët kanë plotësuar detyrimet e tyre të shlyerjes. Pranimi i rrezikut të shlyerjes në treg të lirë kërkon aprovime specifike të transaksionit ose prej palëve nga Administrimi i Rrezikut të Bankës.

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka mund të ndeshë vështirësi për të përmbushur detyrimet që rrjedhin detyrimet e saj financiare.

## Menaxhimi rrezikut të likuiditetit

Përjasja e Bankës për të administruar likuiditetin është të sigurojë, sa më gjatë të jetë e mundur, që ajo do të ketë gjithnjë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj në kohë, si në kushte normale dhe në kushte të vështira, pa pësuar humbje të papranueshme apo të dëmtojnë reputacionin e Bankës.

Politikat dhe procedurat e likuiditetit janë objekt i miratimit dhe rishikimit nga ALCO.

Menaxhimi i procesit të likuiditetit të Bankës përfshin:

Financimin e përditshëm, të menaxhuar nga monitorimi i flukseve të ardhshme të mjeteve monetare për të siguruar përmbushjen e kërkesave. Këtu përfshihet rimbushja

e fondeve në kohën që maturohen ose merren hua nga klientët;

Mbajtjen e një portofoli aktivesh të tregtueshme dhe një linje finacimi në tregun monetar nga Shoqëria Mëmë e rishikuar në baza vjetore;

Monitorimin e raporteve të likuiditetit të bilancit kundrejt kërkesave të brendshme dhe rregullatore; dhe Menaxhimin e përqendrimit dhe profilizimit e borxheve të maturuara.

Përgjegjësia për administrimin e situatës së përditshme të likuiditetit mbetet në monitorimin e Sektorit të Thesarit. Raportet e përditshme mbulojnë flukset e vlerësuar monetare të projektuara për ditën, javën, dhe muajin pasues të cilat konsiderohen si periudha kyçe të menaxhimit të likuiditetit. Pika e nisjes për këto projekte është analiza e maturitetit kontraktual të detyrimeve financiare dhe data e pritshme e mbledhjes për aktivet financiare. Menaxhimi i likuiditetit për periudhat afatshkurtëra dhe afatmesme është në përgjegjësinë e ALCO-s. ALCO analizon mbi një bazë mujore situatën e likuiditetit të Bankës dhe propozon veprimet që konsiderohen si të nevojshme.

## Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Elementi kyc i përdorur nga Banka për administrimin e rrezikut të likuiditetit është raporti i aktiveve likuide me detyrimet afatshkurtra dhe hendekun 3 mujor kumulativ. Për këtë qëllim aktivet likuide konsiderohen mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj dhe portofoli i letrave me vlerë të vlefshme për shitje. Raportet e likuiditetit të përcaktuara nga Banka janë në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë të vendosura nga Rregullorja “Mbi administrimin e rrezikut të likuiditetit”

Banka mëmë merr përsipër të mbështesë Bankën duke mbajtur një linjë kredie të nevojshme për të mbuluar nevojat e likuiditetit duke marrë parasysh situatën më të keqe të likuiditetit. Linja rishikohet mbi bazë vjetore, duke u mbështetur në buxhetin e miratuar.

Banka përllogarit mbi baza javore raportet e mëposhtme: aktivet likuide ndaj pasiveve afatshkurtra, kreditë ndaj de-

pozitave dhe aktiveve likuide ndaj depozitave. Aktivet likuide janë konsideruar të përfshijnë mjetet monetare dhe ekuivalentët, bonot e thesarit të qeverisë Shqiptare dhe çdo depozitë afatshkurtër me bankat të cilat maturohen brenda 7 ditëve. Detajet e aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra gjatë periudhës raportuese kanë qenë si më poshtë:

	31 December 2013	31 December 2012
Mesatarja e periudhës	40.46%	48.35%
Minimumi i periudhës	32.09%	38.38%
Maximum i periudhës	52.20%	60.78%

Hendekët e maturimit për çdo monedhë kryesore llogariten dhe analizohen nga Banka në baza mujore. Tabelat e mëposhtme tregojnë një analizë të aktiveve dhe detyrimeve të Bankës më 31 Dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012, sipas maturitetit të mbetur më të hershëm.

Tabela vijuese tregon gjendjen e likuiditeti të Bankës siç monitorohet aktualisht nga drejtimi i Bankës më 31 Dhjetor 2013. Janë marrë në konsideratë flukset monetare të paskontuara hyrëse/dalëse të Bankës për te dhe nga aktivet dhe detyrimet kontraktuale dhe duke mos reflektuar ndonjë ripagesë të hershme apo supozime për historikun e mbajtjes.

<b>31 Dhjetor 2013</b>	<b>Deri në 1 muaj ALL '000</b>	<b>1-3 muaj ALL '000</b>	<b>3-12 muaj ALL '000</b>	<b>1-5 vite ALL '000</b>	<b>mbi 5 vite ALL '000</b>	<b>Totali ALL '000</b>
<b>AKTIVE (Flukse hyrëse)</b>						
Mjete monetare neto	1,184,565	-	-	-	-	1,184,565
Kërkesa minimale të rezervave	1,744,456	-	-	-	-	1,744,456
Paradhënie bankave	1,631,356	-	-	-	-	1,631,356
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	106,272	196,431	736,315	-	-	1,039,018
Hua ndaj bankave	2,342,156	1,753,134	-	-	-	4,095,290
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve (huatë e pa zhvlerësuara)	980,941	924,484	5,320,028	5,131,084	2,959,790	15,316,327
Aktive financiare të tjera	159,967	-	-	-	-	159,967
<b>TOTALI</b>	<b>8,149,713</b>	<b>2,874,049</b>	<b>6,056,343</b>	<b>5,131,084</b>	<b>2,959,790</b>	<b>25,170,979</b>

<b>DETYRIME (Flukse dalëse)</b>						
Llogari rrjedhëse të bankave	9	-	-	-	-	9
Llogari rrjedhëse të klientëve	3,990,199	-	-	-	-	3,990,199
Depozita nga bankat	-	-	-	-	6,024,604	6,024,604
Depozita nga klientët— Depozita me afat	2,918,027	1,805,822	10,418,496	456,948	-	15,599,293
Borxhi i varur	6,901	5,057	23,570	936,983	574,108	1,546,619
Detyrime të tjera financiare	197,586	-	-	-	-	197,586
<b>TOTALI</b>	<b>7,112,722</b>	<b>1,810,879</b>	<b>10,442,066</b>	<b>1,393,931</b>	<b>6,598,712</b>	<b>27,358,310</b>
<b>HENDEKU TOTAL NË BILANC</b>	<b>1,036,991</b>	<b>1,063,170</b>	<b>(4,385,723)</b>	<b>3,737,153</b>	<b>(3,638,922)</b>	<b>(2,187,331)</b>

Llogaritë jashtë bilancit (Flukse hyrëse)	-	-	-	-	-	-
Llogaritë jashtë bilancit (Flukse dalëse)	80,728	98,331	847,782	140,350	-	1,167,191
<b>HENDEKU TOTAL JASHTË BILANCIT</b>	<b>(80,728)</b>	<b>(98,331)</b>	<b>(847,782)</b>	<b>(140,350)</b>	<b>-</b>	<b>(1,167,191)</b>

<b>HENDEKU TOTAL 31 Dhjetor 2013</b>	<b>956,263</b>	<b>964,839</b>	<b>(5,233,505)</b>	<b>3,596,803</b>	<b>(3,638,922)</b>	<b>(3,354,522)</b>
<b>HENDEKU KUMULATIV 31 Dhjetor 2013</b>	<b>956,263</b>	<b>1,921,102</b>	<b>(3,312,403)</b>	<b>284,400</b>	<b>(3,354,522)</b>	<b>-</b>

<b>31 Dhjetor 2012</b>	<b>Deri në 1 muaj ALL '000</b>	<b>1-3 muaj ALL '000</b>	<b>3-12 muaj ALL '000</b>	<b>1-5 vite ALL '000</b>	<b>mbi 5 vite ALL '000</b>	<b>Totali ALL '000</b>
<b>AKTIVE (Flukse hyrëse)</b>						
Mjete monetare neto	1,642,088	-	-	-	-	1,642,088
Kërkesa minimale të rezervave	1,644,186	-	-	-	-	1,644,186
Paradhënie bankave	3,458,004	-	-	-	-	3,458,004
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	53,397	160,114	724,758	-	-	938,269
Hua ndaj bankave	1,995,261	349,020	-	-	-	2,344,281
Hua dhe paradhënie për klientët (huatë e pa zhvlerësuara)	1,800,674	857,341	5,129,790	6,114,372	4,268,938	18,171,115
Aktive financiare të tjera	76,593	-	-	-	-	76,593
<b>TOTALI</b>	<b>10,670,203</b>	<b>1,366,475</b>	<b>5,854,548</b>	<b>6,114,372</b>	<b>4,268,938</b>	<b>28,274,536</b>

<b>DETYRIME (Flukse dalëse)</b>						
Llogari rrjedhëse të bankave	9,176	-	-	-	-	9,176
Llogari rrjedhëse të klientëve	1,721,421	124,299	559,345	1,161,046	370,157	3,936,268
Depozita nga bankat	11,046	21,378	97,628	520,209	9,028,821	9,679,082
Depozita nga klientët— Depozita me afat	1,864,862	3,096,552	8,576,847	130,995	-	13,669,256
Borxhi i varur	6,974	5,042	149,130	824,075	583,926	1,569,147
Detyrime të tjera financiare	132,419	-	-	-	-	132,419
<b>TOTALI</b>	<b>3,745,898</b>	<b>3,247,271</b>	<b>9,382,950</b>	<b>2,636,325</b>	<b>9,982,904</b>	<b>28,995,348</b>
<b>HENDEKU TOTAL NË BILANC</b>	<b>6,924,305</b>	<b>(1,880,796)</b>	<b>(3,528,402)</b>	<b>3,478,047</b>	<b>(5,713,966)</b>	<b>(720,812)</b>

Llogaritë jashtë bilancit (Flukset hyrëse)	-	-	-	-	-	-
Llogaritë jashtë bilancit (Flukset dalëse)	68,713	59,496	701,347	119,772	-	949,328
<b>TOTAL GAP OFF-BALANCE SHEET</b>	<b>(68,713)</b>	<b>(59,496)</b>	<b>(701,347)</b>	<b>(119,772)</b>	<b>-</b>	<b>(949,328)</b>
<b>HENDEKU TOTAL 31 Dhjetor 2012</b>	<b>6,855,592</b>	<b>(1,940,292)</b>	<b>(4,229,749)</b>	<b>3,358,275</b>	<b>(5,713,966)</b>	<b>(1,670,140)</b>
<b>HENDEKU KUMULATIV 31 Dhjetor 2012</b>	<b>6,855,592</b>	<b>4,915,300</b>	<b>685,551</b>	<b>4,043,826</b>	<b>(1,670,140)</b>	<b>-</b>

#### (d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe normat e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në balancën e kredisë të kredihënësit apo kredimarrësit) do të ndikojë në flukset monetare, të ardhurat apo vlerën e instrumentave financiarë të Bankës. Objektiv i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm duke optimizuar kthimin nga rreziku.

#### Administrimi i rrezikut të tregut

Banka e ndan ekspozimin ndaj rrezikut të tregut në portofole të tregëtueshme dhe jo të tregëtueshme. Pozicioni ndaj kursit të këmbimit është trajtuar si pjesë e portofolit tregtar të Bankës për qëllime të administrimit të rrezikut. Portofolet jo tregtare rrjedhin kryesisht nga administrimi i rrezikut të normës së interesit të aktiveve dhe detyrimeve bankare të individëve dhe tregtare. Portofolet jo tregtare gjithashtu konsistojnë në rreziqet që rrjedhin nga investimet të mbajtura deri në maturim dhe të vlefshme për shitje të Bankës. Autoriteti për rrezikun e tregut i atribohet ALCO. ALCO është përgjegjës për zhvillimin e politikave të detajuara të administrimit të rrezikut si dhe për kontrollin e zbatimit të saj ditë pas dite.

31 Dhjetor 2013	ALL LEK '000	EUR LEK '000	USD LEK '000	Other LEK '000	Total LEK '000
<b>Aktivitet</b>					
Mjetet monetare dhe balancat me Bankës Qëndrore	1,269,686	1,329,594	329,741	-	2,929,021
Hua dhe paradhënie ndaj bankave	1,150,095	3,924,054	643,962	7,839	5,725,950
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	983,609	-	-	-	983,609
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve	1,803,356	15,005,649	506,305	-	17,315,310
Aktive të tjera financiare	2,201	157,053	713	-	159,967
<b>Totali</b>	<b>5,208,947</b>	<b>20,416,350</b>	<b>1,480,721</b>	<b>7,839</b>	<b>27,113,857</b>
<b>Detyrime</b>					
Detyrime ndaj bankave	9	5,303,934	-	-	5,303,943
Detyrime ndaj klientëve	9,078,636	8,510,840	1,429,452	6,738	19,025,666
Borxhi i varur	-	1,420,350	-	-	1,420,350
Detyrime të tjera financiare	175,250	18,475	3,860	-	197,585
<b>Totali</b>	<b>9,253,895</b>	<b>15,253,599</b>	<b>1,433,312</b>	<b>6,738</b>	<b>25,947,544</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>(4,044,948)</b>	<b>5,162,751</b>	<b>47,409</b>	<b>1,101</b>	<b>1,166,313</b>

#### Ekspozimi ndaj rrezikut të tregut

Banka është e ekspozuar ndaj efektit të luhatjeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja në pozicionin e saj financiar dhe flukseve monetare. Në ndjekje të politikave të grupit për qëllim të likuiditetit Banka mban një portofol aktivësh të vlefshme për shitje. Aktivet e vlefshme për shitje janë në monedhën vendase dhe përbehen nga bonot e thesarit të Qeverisë Shqiptare. Ky portofol vlerësohet me vlerën e tregut duke përdorur normat e disponueshme të interesit të tregut. Politika e grupit nuk e lejon bankën të mbajë portofol të letrave me vlerë të mbajtura deri në maturitet.

#### Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Bordi i Drejtorëve vendos kufij mbi nivelin e ekspozimit për të dy pozicionet, njëditore dhe brenda ditës të cilat monitorohen çdo ditë nga Njësia e Zyrës së Ndërmjetme. Analiza e mëposhtme përfshin vetëm aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në LEK dhe monedha të huaja. Aktivet jo-monetare nuk konsiderohen të shkaktojnë ndonjë rrezik këmbimi material dhe rrjedhimisht janë përjashtuar nga analiza.

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 Dhjetor 2013 është si më poshtë:

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 Dhjetor 2012 është si më poshtë:

31 Dhjetor 2012	ALL LEK '000	EUR LEK '000	USD LEK '000	Other LEK '000	Total LEK '000
<b>Aktivitet</b>					
Mjetet monetare dhe balancat me Bankës Qëndrore	1,092,688	1,825,046	368,539	-	3,286,273
Hua dhe paradhënie ndaj bankave	250,025	4,954,539	592,559	5,006	5,802,129
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	851,926	-	-	-	851,926
Hua dhe paradhënie ndaj klientëve	744,385	18,202,644	468,143	-	19,415,172
Aktive të tjera financiare	27,886	47,966	742	-	76,594
<b>Totali</b>	<b>2,966,910</b>	<b>25,030,195</b>	<b>1,429,983</b>	<b>5,006</b>	<b>29,432,094</b>
<b>Detyrime</b>					
Detyrime ndaj bankave	9	8,780,734	-	-	8,780,743
Detyrime ndaj klientëve	7,332,356	8,328,502	1,378,274	3,256	17,042,388
Borxhi i varur	-	1,414,269	-	-	1,414,269
Detyrime të tjera financiare	38,102	59,381	34,936	-	132,419
<b>Totali</b>	<b>7,370,467</b>	<b>18,582,886</b>	<b>1,413,210</b>	<b>3,256</b>	<b>27,369,819</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>(4,403,557)</b>	<b>6,447,309</b>	<b>16,773</b>	<b>1,750</b>	<b>2,062,275</b>

Më 31 Dhjetor 2013 Banka nuk ka kontabilitet mbrojtës. Banka ka vetëm transaksione mbrojtëse ekonomike gjatë periudhës së raportimit.

Tabela më poshtë paraqet ndryshimet e fitimit dhe humbjes ndaj ndryshimeve të mundshme në kurset e këmbimit (+/- 10%) të aplikuar në datën e bilancit, me variablat e tjera të mbajtura konstante:

	Pozicioni i hapur valutor më 31 Dhjetor		Efektet e Zhvlerësimit të LEK-ut në Pasqyrën e të Ardhurave gjithëpërfshirëse		Efektet e Vlerësimit të LEK-ut në Pasqyrën e të Ardhurave gjithëpërfshirëse	
	2013	2012	2013	2012	2013	2012
USD	3,853	(21,092)	385	(2,109)	(385)	2,109
EUR	(936,643)	1,409,286	(93,664)	140,930	93,664	(140,930)
